

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7773 E premte 25 Janar 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Ka qenë një javë thëllësisht demoralizuese për median amerikane dhe kulturën demokratike - me pasojë që mund të tregojnë se gjërat do të përkeqësohen ...
Vijon në faqen 20

Nga "THE WEEK"

Orwelli dhe rreziku tiranik i medias sociale



Opinion i Ditës

Ajo që po ndodh në universitete është një festë e vërtetë demokracie. Ndoshta, një ngjarje e paprecedentë në këto tri dekada që pas rënies së komunizmit ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDI BUSHATI

Miti që po thyhet në universitete



49-vjeçari ishte në kërkim nga policia

Turku i laboratorit të heroinës gjendet i vdekur. TV italian: Si vepron mafia shqiptare

Nejdet Cesuroglu akuzohet si pjesë e grupit të "Vol-Vo 4". U gjet në Prishtinë me 113 kg drogë

TIRANË. Nejdet Cesuroglu alias Lavdërim Limani, një nga personat më të kërkuar nga policia shqiptare për ngritjen dhe funksionimin e laboratorit të heroinës në fshatin Brenog të Hasit që u shkatërrua gjatë operacionit "Vol-Vo 4" në tetor të vitit që shkoi është gjetur i vdekur Kosovë. Mësohet se 49-vjeçari turk është gjetur i pajetë ...
Në faqen 2-3

ZYRA E PASURIVE TE PALUAJTSHME: DERI NE KORRIK DO MARRIN HIPOTEKEN

10 MIJE LEJE LEGALIZIMI REGJISTROHEN PER 6 MUAJ

Drejtori Valdrin Pjetri: Problemi, dëmtimi i dokumenteve. Procedura, si ta regjistroni pronën në Hipotekë brenda 10 ditëve në portalin "e-Albania"



(Në foto) Ndërtime informale

Në faqen 8

INTERVISTA NE "NEWS 24"

Ambasadori rumun: Ne e mbështesim anëtarësimin e Shqipërisë në BE

Në faqen 17

ISH-MINISTRI I JASHEM

Paskal Milo: Cakaj të fshijë me punë mëdyshjet. 'Letra' i firmos Edi Rama

Në faqen 6

DEBATI PER PRESIDENTIN

Kaos në Venezuelë, Rama dhe Thaçi i bashkohen Trumpit: S'e njohim Maduron

Në faqen 15

INTERVISTA

Aktorja Ina Gjonçi: Mes tiranisë së shtatzënisë dhe e drejta-detyrë

Në faqen 19

RREFEHEN NENE E BIJE



Nëna 45-vjeçare: Burri ngacmon seksualisht vajzën, policia më refuzoi

Në faqen 10

Lista zyrtare/ Emrat e të deleguarve të PD-së në çdo njësi në Tiranë

Udhëzimi i Bashës, si ndahen deputetët në rrethe

Kreu i PD: Thirrje në "Facebook". Kryemadhi: 16 shkurti të na bashkojë

NGA VALENTINA MADANI

Srejtuesit demokratë, deputetët dhe antarët e kryesisë së re janë shpërndarë në të gjithë vendin në kuadër të përgatitjeve për protestat masive kundër qeverisë "Rama". Në funksion të këtyre protestave dhe arrijten



e një pjesëmarrje sa më të madhe më 16 shkurt. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha ka urdhëruar deputetët, kryetarët e degëve dhe të deleguarit të organizojnë strukturat për protestat. "GSH" disponon udhëzimin, i cili kërkon që mes ...

Në faqen 7

TRAFIKU I DROGES HETIMET

Publikohet dokumentari, ja si funksionon biznesi fitimprurës i trafikëve ilegale


"Mafia shqiptare terrorizon Europën, nuk mendohen dy herë për të të vrarë"

RRËFIMI I GAZETARIT SPANJOLL: GRUPET KRIMINALE SHQIPTARE RESPEKTOJNË KODIN E NDERIT DHE HAKMARRJES

ITALI

Operacionet antidrogë të kryera në disa vende të Europës si në Itali, Spanjë, Holandë, Angli etj. dhe arrestimet e shumë shqiptarëve kanë bërë bujë në mediat ndërkombëtare, të cilat jo në pak raste kanë shkruar se ata janë kapot e trafikut të lëndëve narkotike. Por mediat nuk kanë qëndruar thjesht në kuadrin e dhënies së informacionit, disa prej tyre kanë publikuar dokumentare mbi të. Mbrëmjen e të martës në Itali, kanali "TV Nove" ka transmetuar dokumentarin "Clandestino" të gazetarit investigativ spanjoll David Beriain mbi mafien shqiptare. Ai e përshkruan mafien shqiptare si "një organizatë brutale dhe efiçente, e cila e ka gjenezën që në kohën e luftërave ballkanike.

Në përshkrimin e gazetarit thuhet mes tjerash se mafia shqiptare fillimisht ka qenë në grupe të vogla, por zhvillimin e mori pas lidhjeve me qarqet politike. Kjo mbështetje sipas gazetarit investigativ i dha një hov 'oreksit' të mafies shqiptare në trafikimin e drogës, armëve dhe qenieve njerëzore". "Lobi shqiptar është i mbyllur. Prej tij shumë pak dihet dhe për herë të parë hap derën për një gazetar", thekson ai. Ndërkaq, në një nga pjesët e dokumentarit transmetohet momenti kur një nga trafikantët pret në brigjet e Italisë një ngarkesë prej 5 kg kokainë, e cila ishte nisur nga Shqipëria dhe po transportohej me skaf. Gazetari shkëmben edhe një dialog me anëtarin e mafies shqiptare, i cili nuk kursen ta pyes për sasinë: "Pse vetëm 5 kg dhe nuk transportoni më shumë? Ndërsa trafikanti i kthen përgjigjen si vijon: "Është më e lehtë që një njeri të transportojë 5 kg. Nëse



Gazetari spanjoll duke intervistuar trafikantët e drogës



LIDHJA ME POLITIKËN

Në përshkrimin e gazetarit investigativ spanjoll, David Beriain thuhet mes tjerash se mafia shqiptare fillimisht ka qenë në grupe të vogla, por zhvillimin e mori pas lidhjeve me qarqet politike. Kjo mbështetje sipas gazetarit i dha një hov 'oreksit' të mafies shqiptare në trafikimin e drogës, armëve dhe qenieve njerëzore. "Lobi shqiptar është i mbyllur. Prej tij shumë pak dihet dhe për herë të parë hap derën për një gazetar", thekson Beriain.

humb një person, nuk më intereson. Nëse humbas 100 kg, më intereson shumë".

Pjesë nga dialogu mes gazetarit dhe trafikantit:

Gazetari: Më fol për mafien shqiptare. Si do ta përshkruaje ti?

Trafikanti: "Është si familja. Nuk flitet për të. Unë nuk flas për familjen


"time", - thotë i riu me fytyrë të mbuluar. Më poshtë një tjetër video që tregon një person që falsifikon dokumente për shqiptarët, gjë që i jep mijëra euro. Shqiptarët paguajnë 5 mijë euro për të pasur një pasaportë europiane për t'u larguar nga ky vend. Një biznes i majmë dhe ky me një fitim prej 600 mijë

TRAFIQUET ILEGALE

Në dokumentar u tregua se si funksionon biznesi fitimprurës dhe marramendës i trafikëve ilegale të mafies shqiptare drejt Italisë e Europës. I infiltruar në brendësi të këtyre grupeve, gazetari spanjoll rrefeu trafikun e kokainës, marijuanës, heroinës, armëve, pasaportave false, bombave artizanale, lidhjeve me mafien napolitane "Camorra" përmes dëshmitve ekskluzive të anëtarëve të mafies shqiptare dhe asaj italiane. Davide Beriain e nisi udhëtimin në brigjet italiane, aty ku pothuajse çdo ditë mbërrijnë përmes detit kokainë, heroinë, marijuanë, por edhe armë.

euro në vit. "Hakmarrja për shqiptarët është një detyrim i jetës. Vrasja e një të afërmi, siç thuhet në ligjin e Kanunit, kërcënon me vdekje të gjithë meshkujt e familjes së vrasësit", - thuhet në dokumentar.

"Është pikërisht kjo karakteristikë kryesore e organizatave kriminale shqiptare. Ato janë formuar në bazë të lidhjeve familjare dhe nga një kod i pashkruar i nderit dhe hakmarrjes", - thuhet më tej. Në dokumentar u tregua se si funksionon biznesi fitimprurës dhe marramendës i trafikëve ilegale të mafies shqiptare drejt Italisë e Europës. I infiltruar në brendësi të këtyre grupeve, gazetari spanjoll rrefeu trafikun e kokainës, marijuanës, heroinës, armëve, pasaportave false, bombave artizanale, lidhjeve me mafien napolitane "Camorra" përmes dëshmitve ekskluzive të anëtarëve



Heroina e sekuestruar në fshatin Brenog të Hasit

KODI I NDERIT DHE HAKMARRJES

"Hakmarrja për shqiptarët është një detyrim i jetës. Vrasja e një të afërmi, siç thuhet në ligjin e Kanunit, kërcënon me vdekje të gjithë meshkujt e familjes së vrasësit", - thuhet në dokumentar. "Grupet mafioze shqiptare janë të organizuara në bazë familjesh, lidhje gjaku dhe fisnore që respektojnë kodin e Kanunit. Nuk ka një kupolë drejtuese, por çdo grup ka kreun e tij. Është pikërisht kjo, karakteristikë kryesore e organizatave kriminale shqiptare. Ato janë formuar në bazë të lidhjeve familjare dhe nga një kod i pashkruar i nderit dhe hakmarrjes", - theksohet më tej në dokumentarin "Clandestino".

të mafies shqiptare dhe asaj italiane.

Davide Beriain e nisi udhëtimin në brigjet italiane, aty ku pothuajse çdo ditë mbërrijnë përmes detit kokainë, heroinë, marijuanë, por edhe armë.

"Grupet mafioze shqiptare janë të organizuara në bazë familjesh, lidhje gjaku dhe fisnore që respektojnë kodin e Kanunit. Nuk ka një kupolë drejtuese, por çdo grup ka kreun e tij", - thuhet në dokumentar. Më pas rrëfimi spostohet në Shqipëri, ku mes maleve e vendeve të fshehta ku kultivohet marijuana e ku merren në dorëzim sasitë e kokainës e heroinës. Një prej personave që ruan një plantacion thotë se nga kjo fitohet 5 deri 6 milionë euro, por nga ajo fitojnë të gjithë nga kultivuesit dhe ata që e transportojnë.

Heroina e transportuar nga Turqia hyn në Shqipëri përmes kufirit me Kosovën. Kokaina që vjen nga Amerika Latine ndalet në Rotterdam dhe më pas vjen në Shqipëri për t'u hedhur në të gjithë Europën. Gazetari spanjoll zbulon se prej kohësh një anëtar i një prej familjeve mafioze të "Camorra" ndodhet në Shqipëri. Në emrin e sajuar Simone dhe me fytyrë të fshehur ai drejton

gazetarin në një prej rrugëve ku do të dorëzohet sasia e heroinës së kërkuar: "50-80 kg heroinë në javë, dhjetëra kilogramë kokainë, qindra kilogramë marijuanë. Fitimet janë të paimagjinueshme. Për klientët e besuar dhurohet për çdo ngarkesë droge një kallashnikov që në Shqipëri blihet për 300 euro, ndërsa në Itali mbi 1500 euro", - thuhet në dokumentar. "Mu desh kohë, rrefën Simone, të fitoj besimin e shqiptarëve. Po gabove vetëm një herë ata të vrasin. Nuk duhet të gabosh kurrë se e paguan me jetën. Shqiptarët nuk mendohen dy herë për të vrarë", - rrefën gazetari. Një tjetër shqiptar me emrin e koduar "Denis" është një prej organizuesve të trafikut të marijuanës me skafë drejt Italisë. Ai rrefën për krime makabre ndaj kujtdo që ka provuar të luajë në mënyrë të pistë me mafien shqiptare. "3 persona u therën copë-copë dhe u gruposën se tradhtuan", thotë një grua, që shton: "Nëse je pjesë e mafies shqiptare, nuk del me kurrë". "Mafia shqiptare terrorizon Europën, por që dhe i jep Europës atë që kërkon, drogën", - e mbyll dokumentarin e tij gazetari investigativ spanjoll, Davide Beriain.



Në banesën ku fshihej 49-vjeçari u sekuestruan 113 kg heroinë, kapen 2 bashkëpunëtorët

Laboratori i drogës në Has, gjendet i vdekur në Prishtinë turku i shumëkërkuar

Misteri, Krimet e Rënda letërporosi Prishtinës për shkaqet e humbjes së jetës së Nejdet Cesuroglu

TIRANË

Nejdet Cesuroglu alias Lavdërim Limani, një nga personat më të kërkuar nga policia shqiptare për ngritjen dhe funksionimin e laboratorit të heroinës në fshatin Brenog të Hasit që u shkatërrua gjatë operacionit "Vol-Vo 4" në tetor të vitit që shkoi është gjetur i vdekur Kosovë. Mësohet se 49-vjeçari turk është gjetur i pajetë në rrethana misterioze më 2 dhjetor të vitit 2018, në një apartament, në rrugën "Jakov Xoxa" në Prishtinë. Ndërkaq, konfirmohet se në këtë apartament janë prangosur edhe turku 35-vjeçar Iskander Saleh dhe kosovari Xhemal Sala, edhe këta të shpallur në kërkim nga autoritetet shqiptare. Policia e Kosovës gjatë kontrollit të banesës ka gjetur edhe një sasi prej 113 kg e 507 gr heroinë që ishte gatshme për t'u tregtuar. Janë ende të paqarta shkaqet e vdekjes së 49-vjeçarit. Mësohet se Prokuroria shqiptare ka nisur një letërporosi drejt Kosovës, ku kërkon të dhënat mbi vdekjen e tij dhe arsyet. Nuk dihet nëse Cesuroglu është vrarë apo ka pasur një vdekje natyrale, por kjo pritet të sqarohet nga informacionet që do vijnë nga Prishtina.

PROKURORIA
Organi i akuzës në Shqipëri është informuar për ngjarjen në fjalë (vdekjen e turkut) në fillim të dhjetorit të vitit të kaluar: "Në kuadër të hetimeve për procedimin penal numër 339 të vitit 2016 është caktuar nga Gjykata për Krime të Rënda masa e sigurimit arrest në burg në mungesë për njërin prej personave të dyshuar si anëtar të grupit kriminal, shtetasit turk Nejdet Cesuroglu, që ka lidhje për faktin e zbulimit të laboratorit dhe të lëndës narkotike më datë 18.10.2018 në fshatin Brenogë Has. Nga Policia e Shtetit jemi njoftuar se më datë 02.12.2018 në Prishtinë, në kuadër të operacionit "FIRMA", është gjetur i vdekur shtetasi turk Nejdet Cesuroglu, i datëlindjes 03.02.1969. Gjatë kontrollit të banesës, tek një dhomë e mbyllur janë gjetur tri valixhe të mbushura me 113 kg e 507 gramë lëndë heroinë, për këtë fakt janë arrestuar nga autoritetet kosovare katër shtetas", deklaroi prokuroria shqiptare. Sipas dosjes të Prokurorisë së Krimeve të



Laboratori i drogës në Has

MISTERI

Burime policore bënë me dije se në apartamentin ku u gjet i vdekur 49-vjeçari Nejdet Cesuroglu alias Lavdërim Limani janë prangosur edhe turku 35-vjeçar Iskander Xhemal Sala, edhe këta të shpallur në kërkim nga autoritetet shqiptare. Policia e Kosovës gjatë kontrollit të banesës ka gjetur edhe një sasi prej 113 kg e 507 gr heroinë që ishte gatshme për t'u tregtuar. Janë ende të paqarta shkaqet e vdekjes së 49-vjeçarit.

Sekuestrohen 5.2 mln euro dhe 7 apartamente në pronësi të 2 lezhjanëve

LEZHË - Rreth 5.2 mln euro llogari bankare dhe pasuri të paluajtshme (7 apartamente) të dy shtetasve, të dyshuara se janë përfittuar nga veprimtari kriminale janë sekuestruar dhe në Lezhë. Policia deri më tani nuk i ka bërë publikë emrat e poseduesve të pasurive të sekuestruara. Mësohet se pasuritë në fjalë janë në pronësi të 83-vjeçarit Pjetër Voci dhe 50-vjeçares Shqipe Palaj (babë e bijë). Sekuestrat, siç bëhet me dije janë ekzekutuar në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit" dhe janë rezultat i punës hetimore të policisë së Lezhës, që ka referuar materialet procedurale mbi bazën e dyshimit të arsyeshëm, për përfittimin e tyre nga veprimtaria kriminale, me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lezhë. Prokuroria ka filluar procedimin penal për veprën "Pastrim i produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale" në ngarkim të dy shtetasve të mësipërm, duke e finalizuar me sekuestrat të vendosur nga Gjykata e Shkallës Parë Lezhë me vendim të datës 23 janar 2019. Ndërkaq, më datë 22.01.2019, Prokuroria e Lezhës ka regjistruar procedimin penal nr. 57 viti 2019 për veprën penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Me kërkesën e prokurorit Erjon Shehaj, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë më 23.01.2019 ka vendosur sekuestrimin e llogarive bankare me vlerë 5.269.551 euro, 7 apartamente në Lezhë si dhe disa apartamenteve në Tiranë në pronësi të Pjetër Vocit dhe Shqipe Palaj, të dy banues në Lezhë. Nga ana tjetër, mësohet se hetimet e policisë së Lezhës nisën menjëherë, pasi në llogaritë bankare në emër të 50-vjeçares mbërritën shuma të mëdha parash, në një kohë të shkurtër. Sipas TV "Klan", paratë janë dërguar nga një shtetas suedez. Transferrat kanë nisur që prej vitit 2013, por pjesa e mëmadhe e tyre është dërguar drejt filialit të një banke në Lezhë, vitin e kaluar. Vetëm në korrik dhe gusht në llogarinë e 50-vjeçares kanë mbërritur 2 milionë euro. Të njëjtat burime thanë se paratë investoheshin menjëherë në blerje pasurish të paluajtshme në Lezhë, Shëngjin dhe Tiranë. Sipas informacioneve të marra në mënyrë konfidenciale, bëhet e ditur se 50-vjeçarja mund t'i ketë marrë këto para të dërguar nga kunati dhe vëllai i saj. Me gjithë dyshimet e forta për para që vijnë nga aktivitetet kriminale, që kanë të bëjnë me trafikimin e drogës, hetimi për 50-vjeçaren dhe babain e saj do të bëhet në gjendje të lirë. Policia ka kërkuar nga homologët në Zvicër të tjerë detaje për aktivitetin e familjarëve të Palajit në Zvicër dhe për pyetjet e këtyre parave.



TAKIMI NË RINAS

Prokuroria ka dokumentuar një takim mes Admir Hoxhës me dy shtetasit turq Nejdet Cesuroglu alias Lavdërim Limani dhe Iskander Sale në hotelin e tij në Rinas, si dhe me shtetasin nga Kosova, Xhemal Shala. Këta dy persona nga Turqia, sipas Prokurorisë kanë sjellë lëndën e parë për ta kthyer në heroinë. Admir Hoxha, nga vëzhgimet në terren rezultojn se është personi që kishte përgatitur ambientin e kthyer në laborator për prodhimin e lëndës narkotike në bashkëpunim me persona ende të paidentifikuar.

"RONI I SHIJAKUT"

Pak ditë më parë përfundoi në pranga bashkëpunëtorin kryesor i biznesmenit Admir Hoxha, 48-vjeçari Hekuran Hoxha, i njohur ndryshe si "Roni i Shijakut". Një ditë pas vënies në pranga, burime pranë grupit hetimor bënë me dije se dyshohet që 48-vjeçari ishte personi që luante rolin kryesor në trafikimin heroinës, që prodhohej në laboratorin e Hasit. Po të njëjtat burime thanë se Hoxha dyshohet se drejtohte trafikun e drogës nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të Europës.

GRUPI KRIMINAL

Nga të dhënat e siguruar nga dosja e Prokurorisë, biznesmeni Admir Hoxha është njeriu që ka udhëhequr ngritjen e këtij laboratorit në bashkëpunim me disa anëtarë të arrestuar të grupit kriminal nga Shijaku. Admir Hoxha ka mbajtur kontakte me shtetasit Hekuran Hoxha dhe Saimir Gjepali nga Shijaku, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike. Policia ka arrestuar 5 persona për laboratorin e heroinës në Has, dy prej të cilëve u liruan nga gjykata, pasi dyshohet se ishin punonjës.

LABORATORI I HEROINËS

Laboratori i heroinës u zbulua në Brenog të Hasit në kuadër të operacionit "Vol Vo 4", gjatë të cilit u goditën 4 grupe kriminale, me 27 të arrestuar, u shpallën në kërkim edhe 17 persona, 4 prej tyre vetëm për laboratorin. Ideatori i ndërtimit të një objekti të tillë për përpunimin jo vetëm të heroinës, por edhe të kokainës është një biznesmen nga Tirana, pronar i hotelit "Ador Resort", në afërsi të Aeroportit të Rinasit. Nga të dhënat e siguruar nga dosja e prokurorisë, biznesmeni Admir Hoxha është njeriu që ka udhëhequr ngritjen e këtij laboratorit në bashkëpunim me disa anëtarë të arrestuar të grupit kriminal nga Shijaku. Admir Hoxha ka mbajtur kontakte me shtetasit Hekuran Hoxha dhe Saimir Gjepali nga Shijaku, me qëllim

trafikimin e lëndëve narkotike. Policia ka arrestuar 5 persona për laboratorin e heroinës në Has, dy prej të cilëve u liruan nga Gjykata, pasi dyshohet se ishin punonjës. Ndërsa në kërkim u shpallën tre të tjerë, dy turq dhe një shqiptar, midis të cilëve njëri u gjet i vdekur dhe dy të tjerët u vendosën në pranga. Vetëm pak ditë më parë përfundoi në pranga bashkëpunëtorin kryesor i biznesmenit Admir Hoxha, 48-vjeçari Hekuran Hoxha, i njohur ndryshe si "Roni i Shijakut". Një ditë pas vënies në pranga, burime pranë grupit hetimor bënë me dije se dyshohet që 48-vjeçari ishte personi që luante rolin kryesor në trafikimin heroinës, që prodhohej në laboratorin e Hasit. Po të njëjtat burime thanë se Hoxha dyshohet se drejtohte trafikun e drogës nga Shqipëria drejt vendeve të tjera të Europës.

PERPLASJA DEKRETI

Përkujtohet Ismail Qemali, presidenti: Të përmbushim ëndrrën për një Shqipëri europiane

Dekreti për Shaqirin, Meta: Udhëhiqem vetëm nga Kushtetuta

Paralajmëron plotfuqinë për marrëveshjen e detit

Valentina Madani

Mazhoranca është shprehur kundër kandidaturës së propozuar nga presidenti për kreun e KLSH-së Bahri Shaqiri, por vetë z.Meta është i bindur se vendimin e ka marrë në mbështetje të Kushtetutës. Pasi vendosi lule pranë shtatores së themeluesit të shtetit shqiptar Ismail Qemali me rastin e 100-vjetorit të ndarjes nga jeta, Kreu i Shtetit për-mendi Kushtetutën kur u pyet për rezervat e shfaqura nga mazhoranca ndaj Bahri Shaqirit, këshilltarit të tij për Sigurinë. "Kushtetuta, interesi kombëtar dhe interesi publik janë të vetmet që më udhëheqin në veprimet e mia dhe në aktet e mia", theksoi z.Meta. Duke folur pas ceremonisë së homazheve të busti i Ismail Qemalit, Meta u tregua sërisht i rezervuar në komentet për delegimin e kompetencave të Ministrisë të Jashtëm te Gent Cakaj. Ndaj një rast konkret kur presidenti i kërkohet të japë plotfuqinë për marrëveshje ndërkombëtare është ai për paktin detar me Greqinë. Ndonëse jo menjëherë, Presidenti Meta ia dha autorizimin Ditmir Bushatit vitin e kaluar për sa i përket grupit negociator. Por, firma e kreut të shtetit nevojitet edhe një herë të dytë para se marrëveshja të kalojë në parlament, rast në të cilin Meta mund të hezitohet për shkak të rezervave të shprehura publikisht ndaj zv/ministrit Gent Caka, i cili drejton "de facto" diplomacinë shqiptare. Në këto kushte, nuk përjashtohet që presidenti ta marrë vetë drejtimin e grupit negociator, një e drejtë kjo që ia ka njohur edhe Gjykata Kushtetuese. Ndaj z.Meta edhe dje ripërsëriti me indiferencë se nuk komenton organizimin e brendshëm të qeverisë kur u pyet për delegimin nga kryeministri Rama të kompetencave të ministrisë të Jashtëm te zv.ministri Genti Cakaj. Por



DEKLARATA

"Unë e kam shumë të qartë si President i Republikës, edhe për shkak të vendimit vizionar të Gjykatës Kushtetuese, se kujt institucioni mund t'i delegoj autoritetin kushtetues për të lidhur marrëveshje ndërkombëtare në emër të Republikës së Shqipërisë", deklaroi z.Meta.

"Rama, i vendosur në karshillëkun e tij"

Mustafaj: Cakaj tregoi se ishte i paaftë dhe i papërgjegjshëm

Ish-ministri i Jashtëm Besnik Mustafaj tek komentoi dje në studion e News24 delegimin e kompetencave të ministrisë të Jashtëm nga kryeministri Rama te Gent Cakaj, deklaroi se Cakaj tregoi se është i papërgjegjshëm. "Ishte e pritshme. Që në momentet që presidenti po denonconte në mënyrë publike në kemi dëgjuar kreun e grupit parlamentar të PS Taulant Balla i cili ka shpallur se sapo ankimi i PS të përmbushet në Gjykatën Kushtetuese, Cakaj do bëhet edhe de jure ministër i Jashtëm. Kryeministri ka qenë i vendosur në karshillëkun e tij ndaj shumicës absolute të opinionit të shqiptarëve, ndaj shumicës absolute të opinionit politik dhe presidentit, ka qenë i vendosur të çojnë vend idenë e tij", tha z.Mustafaj. I pyetur nëse duhet të ketë takime diplomatike ku Cakaj nuk du-



het të jetë, ish-ministri i Jashtëm mohoi. "Jo nuk ka. Nga ana teknike nuk ka asnjë pengesë që të jetë", tha ai. Mustafaj bëri dhe një interpretim të deklaratës së Presidentit të Republikës Ilir Meta pasi Cakaj mori detyrën nga Rama. "Ka shumë marrëveshje që përcaktojnë se kush duhet t'i nënshkruajë. Të gjithë per-



BUJAR NISHANI

"Edi Rama ia ka deleguar kompetencat dhe firmën zotin Cakaj, por natyrisht për të bërë tenderë dhe për të bërë kancelaritë në Ministrinë e Jashtëm. Presidenti është i detyruar që këtë plotfuqishmëri ta japë me emrin Edi Rama. Duhet të dalë para publikut dhe të deklarojë që unë tërheq deklaratën time dhe firmën që ia kam deleguar", tha z.Nishani.

sonat e tjerë duhet t'i nënshkruajnë me një mandat të dhënë nga presidenti", tha z.Mustafaj. Ish-ministri i Jashtëm foli dhe për njohjen e shpejtë nga Shqipëria dhe Kosova të presidentit të sapozgjedhur të Venezuelës nga ana e opozitës, ndërkohë që presidenti Maduro vijon të jetë komandant i ushtrisë.



Presidenti Ilir Meta dhe kryeministri Edi Rama

Meta: Baza e Kuçovës, investim strategjik

Baza e NATO-s në Shqipëri, Xhaçka: Një lajm i jashtëzakonshëm...

Presidenti Ilir Meta priti dje në takim komandantin amerikan të Forcave Ajrore të NATO-s, Gjeneralin Tod Wolters, i cili ndodhet në një vizitë zyrtare në vendin tonë. Gjatë takimit Meta tha se në 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO dhe 20 vite pas ndërhyrjes ushtarake të Aleancës që i dha fund genocidit në Kosovë dhe rajon, Shqipëria dhe shqiptarët nuk do të harrojnë kurrë dhe do të mbeten gjithmonë mirënjohës

ndaj Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s. Kreu i Shtetit shprehu kënaqësinë e veçantë për përzgjedhjen e Kuçovës si vendndodhje e bazës moderne ajrore të NATO-s, shenjë e besimit dhe vlerësimit që Aleanca ka për Shqipërinë dhe kontributin e saj në sigurinë e rajonit. "Baza ajrore e NATO-s në Kuçovë është një investim strategjik si për sigurinë tonë kombëtare, ashtu edhe për atë rajonale", u shpreh Meta. Gjithashtu, Kreu i Shtetit tha se Shqipëria është e interesuar që NATO të forcohet më tej si në aspektin politik ashtu edhe atë ushtarak dhe siguroi për gatishmërinë për të plotësuar jo vetëm të gjitha detyrimet, por edhe për të marrë përgjegjësi të reja. Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e quajti një "lajm të jashtëzakonshëm", prezencën e NATOS-ë në Kuçovë. Kuçova është një lajm i jashtëzakonshëm për zhvillimin dhe investimet që do kryhen nga aleanca. Dëshmi e një marrëdhënie që vlerëson Shqipërinë në rolin për gjurmën që tenton të promovojë përmes dialogut, stabilitetit, paqes dhe rolit që kryen në rajon",-tha Xhaçka gjatë konferencës së përbashkët me gjeneral Tod Wolters, Komandant i forcave të NATO-s.



identin e Republikës edhe për shkak të vendimit vizionar të Gjykatës Kushtetuese se kujt institucioni mund t'i delegoj autoritetin kushtetues për të lidhur

është shumë i qartë kur vjen puna tek autorizimi që duhet të lëshohet për negociimin dhe firmosjen e marrëveshjeve ndërkombëtare, duke nënkuptuar mar-

rëveshjen e detit me Greqinë. "Nuk kam asnjë koment për organizimet e brendshme të qeverisë apo të pushtetit vendor. Unë e kam shumë të qartë si Pres-

marrëveshje në emër të Republikës së Shqipërisë", theksoi Presidenti Meta. Ish-ministri grek i Jashtëm Nikos Kocias deklaroi se marrëveshja me dy vendeve tona

ishte drejt finalizimit, por ishte presidenti shqiptar ai që po pengonte firmosjen për shkak të mosfunksionimit të Gjykatës Kushtetuese.



Intervista/ kryeministri flet për gazetën gjermane "Die Welt" edhe për artin dhe sportin

Ndryshimet në qeveri, Rama: Kemi nevojë për lojtarë të rinj në fushë

"Jemi akoma të dashuruar, pasi s'jemi martuar ende"

Kryeministri, Edi Rama ka dhënë një intervistë për gazetën e njohur gjermane "Die Welt", ku ka folur në lidhje me ndryshimet në qeveri, të ardhmen e Europës, por edhe për pasionet e tij siç është piktura dhe sporti. Sa i përket ndryshimeve në qeveri, Rama ka deklaruar duke theksuar se ekipi qeveritar që ai drejton ka herë pas here nevojë për lojtarë të rinj që mund t'i japin skuadrës energji të re. Rama ka shuar edhe kurozitetin e gazetarëve gjermanë edhe për sa i përket "dashurisë" së tij me kancelaren Merkel.



Kryeministri Edi Rama

Çfarë keni bërë sot në detyrë në cilësinë e kryeministrit?

Kam ndërruar disa ministra, rreth 70 për qind prej tyre. Kemi thujasë një qeveri të re tani që po flasim.

Cila është arsyeja? Tingëllon si një krizë qeveritare?

Rama: Herë pas here kemi nevojë për energji të re, për lojtarë të rinj në fushë, në mënyrë që të mos bëjmë të njëjtin gabim si kombëtarja gjermane e futbollit pas fitores së Kupës së Botës.

Që u eliminua në mënyrë të turpshme që në raundin e parë pas katër vitesh. Juve ju pëlqen të përdorni metafora sportive, keni luajtur vetë basketboll profesionist. Biografinë e keni të pazakontë. Keni studiuar art përpara se të bëhëni kryebashkiak dhe më pas kryeministër. Ku dallon sporti me artin?

Të dyja janë ekzistenciale për mua. Nuk mund të krahasohen. Si artist, punoja tërësisht në vetvete, diçka e brendshme. Në sport punoj jashtë, me të tjerët, për të arritur diçka të përbashkët.

Si kryebashkiak i lyet godinat gri me ngjyra për të dhënë shpresë tek njerëzit në Tiranë. Në atë kohë bëri shumë përshtypje dhe u krijua ideja se arti mund të ndryshojë shoqërinë në mënyrë të qëndrueshme, ndoshta edhe ta përmirësojë atë. A besoni akoma tek kjo? A është artisti një politikan më i mirë?

Arti nuk mund të ndryshojë shumë gjëra. Ndoshta shkoj larg kur them: nuk ndryshon asgjë fare.

Prisja më shumë ideal-

KRYEMINISTRI
"Të mbash postin e kryeministrit është një punë e vështirë. Por nëse do isha i kënaqur, nuk do isha i duhuri për këtë post. Është diçka që duhet të shkojë më tej. Edhe nëse vetë do isha i kënaqur, nuk do ndalesha kurrë, nuk më shkon për shtat. E njëjta gjë është në art. Unë vazhdoj të vizatoj".

izëm nga goja juaj...

Dua të them se arti nuk është në gjendje të parandalojë gjëra të këqija si lufta, dhuna apo konfliktet. Nuk i bën njerëzit më të mirë. Unë thjesht nuk e besoj këtë. Nuk di ndonjë poezi që ka ndaluar ndonjë gjakderdhje. Nuk di që ndonjë piktor të ketë ndaluar bombat. Natyrisht, unë vlerësoj skulpturat që adresojnë racizimin

është e jashtëzakonshme dhe qasja e njerëzve për mua është shumë e drejtpërdrejtë dhe intensive. Unë vazhdimisht shqyrtoj, gjykoj, marr vendime dhe zhvilloj strategji për të gjetur një mënyrë që vendi ynë të arrijë qëllimet. Toka në të cilën lëviz është gjithmonë në lëvizje. Është si një lojë globale shahu.
A jeni i kënaqur me veten?

mirë. Për fat të keq, nuk mund të lexoj filxhanin e kafesë, e di që ka politikanë të tjerë që besojnë se janë të aftë ta bëjnë këtë. Unë nuk u përkas atyre. Me të vërtetë nuk mund të parashikoj të ardhmen.

Çfarë mund të bëjmë tjetër për demokracinë në Europë?

Nëse mund të jem i singërtë me ju, jo aq shumë, po ju them diçka nga këndvështrimi im. Deri më tani kemi qenë jashtëzakonisht me fat pasi kemi punuar e jetuar në një kohë me kancelaren gjermane, Angela Merkel. Po, bashkë me Angela Merkel dhe Gjermaninë. Unë singërisht shpresoj që ajo të qëndrojë me ne, pasi vizioni i saj nuk humb kaq lehtë. Shpresoj shumë që Gjermania ta kuptojë se nuk është vetëm përgjegjëse për të ardhmen e fëmijëve gjermanë, por edhe të Europës dhe më gjerë. Bëhet fjalë për çështje pushetë mbi të gjitha.

Dhe cila është qasja e vendit tuaj, e popullsisë shqiptare?

Ende e duam Evropën. Jemi gjithmonë të gatshëm për të dhënë PO. Jemi akoma të dashuruar pasi nuk jemi martuar akoma. Pas martesës do e shohim nëse do jemi ende të lumtur.

PËR ARTIN

"Dua të them se arti nuk është në gjendje të parandalojë gjëra të këqija si lufta, dhuna apo konfliktet. Nuk i bën njerëzit më të mirë. Unë thjesht nuk e besoj këtë. Nuk di ndonjë poezi që ka ndaluar ndonjë gjakderdhje. Nuk di që ndonjë piktor të ketë ndaluar bombat. Natyrisht, unë vlerësoj skulpturat që adresojnë racizimin dhe që ju bëjnë të vetdijshëm për një tjetër lloj frike"



Michael Roth vlerëson Bushatin: Një lider politik i guximshëm

Largimi i Ditmir Bushatit nga kreu i diplomacisë shqiptare ka qenë një lëvizje e papritur edhe për disa nga ish-kolegët e tij të huaj. Pas ish-ministrit grek Nikos Kotzias, me superlativa për figurën e Bushatit kanë folur edhe disa ministra të tjerë të Jashtëm, siç është ai i Gjermanisë Michael Roth apo edhe ministrja e Jashtëm e Suedisë Margot Wallstrom. Michael Roth, ministri gjerman për Evropën e quan Bushatin një europian të angazhuar. "Një lider politik i guximshëm, një mik i mirë dhe një europian i angazhuar. Shumë faleminderit i dashur Ditmir Bushati! Do na mungosh", - shkroi Roth në rrjetet sociale. Falënderim për punën e bërë prej tij ka shprehur edhe kryediplomatja suedeze. "Faleminderit Ditmir për punën tuaj, bashkëpunimin e mirë dhe miqësinë! Gjithë të mirat në të ardhmen. Margot Wallstrom", - shkroi ministrja e Jashtëm e Suedisë. Edhe Knut Fleckenstein, eurodeputeti dhe raportuesi për Shqipërinë në BE i shprehur mirënjohjen e tij për bashkëpunimin. "Faleminderit për bashkëpunimin shumë të mirë! Unë shpresoj, ne do të takohemi sërish. Herët a vonë rrugët tona do të kryqëzohen prapë. Dhe unë po pres për këtë moment", - nënvizonte Fleckenstein në mesazhin e tij.



ROTH

"Një lider politik i guximshëm, një mik i mirë dhe një europian i angazhuar. Shumë faleminderit i dashur Ditmir Bushati! Do na mungosh", - shkroi Roth në rrjetet sociale.

INTEGRIMI

Deri më tani kemi qenë jashtëzakonisht me fat pasi kemi punuar e jetuar në një kohë me kancelaren gjermane, Angela Merkel. Po, bashkë me Angela Merkel dhe Gjermaninë.

dhe që ju bëjnë të vetdijshëm për një tjetër lloj frike.
Çfarë do të thotë të udhëheqësh një vend? Që të jesh përgjegjës?

Është jeta e çmendur dhe e egër e një njeriu, që duhet të merrret njëkohësisht me një numër të jashtëzakonshëm fatesh dhe temash. Nuk është më e lehtë që të menaxhosh një vend të vogël sesa të drejtosh një vend të madh, shumëkush nuk e imagjnonin. Shpejtësia e komunikimit

Të mbash postin e kryeministrit është një punë e vështirë. Por nëse do isha i kënaqur, nuk do isha i duhuri për këtë post. Është diçka që duhet të shkojë më tej. Edhe nëse vetë do isha i kënaqur, nuk do ndalesha kurrë, nuk më shkon për shtat. E njëjta gjë është në art. Unë vazhdoj të vizatoj.

Ju udhëtoni shpesh nëpër Europë dhe botë. Si po evoluon Europa?

Do të bëhet shumë më keq përpara se të bëhet sërish

SITUATA POLITIKE

INTERVISTA

Ai e konsideron të drejtë delegimin e kompetencave, por vetëm për çështje administrimi

Milo: Marrëveshjet ndërkombëtare duhet t'i firmosë Rama dhe jo Cakaj

"Cakaj të fshijë me punë mëdyshjet rreth emrit të tij"

Ish-ministri i Jashtëm, Paskal Milo në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" vlerëson se kryeministri është në të drejtë e tij që si ministër i Jashtëm të mund t'i delegojë kompetencat të zëvendës-ministri. Por sipas tij, ky delegim mund të shërbejë vetëm për të ndjekur punët e përditshme të ministrisë, por jo për të nënshkruar marrëveshjet të rëndësishme, apo edhe për të zhvilluar vizita të rëndësishme.

Zoti Milo, kryeministri çoi deri në fund idenë e tij për të vendosur Gent Cakajn në krye të institucionit të Ministrisë së Jashtme, por në cilësinë e zëvendësministrit. Sa të drejtë e shihni ju delegimin e kompetencave të ministrit të zëvendësministrit për të drejtuar me kohë të plotë një ministri kaq të rëndësishme?

Kjo çështje duhet sqaruar në radhë të parë nga konstitucionalistët, të cilët me sa lexova disa shpjegime të tyre, janë të mendimit që në Kushtetutë nuk është e parashikuar delegimi i kompetencave të ministrit të Jashtëm të zëvendësministrit. Por nga ana tjetër, ka një përvojë të njohur nga ligji dhe nga rregulloret e brendshme të organizimit të Këshillit të Ministrave që në mungesë të titullarit të dikasterit me autorizim dhe porosi, kështu thuhet, mund të firmosin dhe të kryejnë detyra administrative edhe zëvendësit. Nga përvoja më e gjerë dihet se dikasteri i Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtohet nga ministri, i cili vetë pastaj në përputhje me problematikën që ka Ministria e Punëve të Jashtme bën ndarje të detyrave, ose delegon detyra edhe tek zëvendësit e vet. Në rastin konkret, unë mendoj se me delegim të detyrës, kryeministri do të ketë parasysh delegimin e atyre kompetencave për drejtimin operativ të Ministrisë së Punëve të Jashtme, që përsëri do thotë meqenëse ai është shumë i ngarkuar me përgjegjësi si kryeministër dhe nuk ka kohë të merret me zbatimin



Ish-ministri i Jashtëm, Paskal Milo

e detyrave të përditshme të Ministrisë së Punëve të Jashtme, mua më duket normale që të ketë një zëvendësministër të autorizuar prej tij që të ndjekë punët e përditshme të ministrisë.

Po sa u përket marrëdhënieve me homologët dhe vizitat e rëndësishme?

Për sa u përket vizitave të rëndësishme jashtë vendit, po e nënvizoj, të rëndësishme, tek partnerët kryesorë ndërkombëtarë apo në takime shumë të rëndësishme ndërkombëtare, besoj se kryeministri duke marrë detyrën e ministrit të Jashtëm duhet t'i realizojë vetë, duhet të marrë pjesë drejtpërsëdrejti vetë. Ndërsa për vizita më pak të rëndësishme, vizita apo pjesëmarrje në forume të ndryshme ndërkombëtare që nuk kanë atë peshë dhe atë rol për Shqipërinë që mund të kenë të tjerat, ai autorizon dhe me të drejtë mund të shkojë edhe zëvendësministri Jashtëm i autorizuar prej tij, sepse ka pasur dhe ka praktika të tilla. Për mendimin tim, edhe marrëveshjet e rëndësishme ndërkombëtare qofshin ato dypalëshe apo shumëpalëshe, patjetër që duhet t'i nënshkruajë kryeministri që ka edhe portofolin e ministrit të Jashtëm.

Për të mbetur tek çështja e fundit që ju prekët, pra si do vepronhet me plotfu-

qishmërinë që duhet të lëshojë presidenti për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve të rëndësishme siç është edhe ajo me Greqinë?

Unë mendoj se në rastin e një marrëveshjeje të tillë kaq delikate dhe kaq shumë të rëndësishme, kryeministri duke pasur edhe zyrarisht detyrën e ministrit të Jashtëm do të duhej ta firmoste vetë. Për një marrëveshjeje të tillë nuk mund të delegohet kompetenca për shkak të rëndësisë së madhe dhe të problematikës që ajo ka.

Sa serioz e bën ky lloj drejtimi dhe ky konflikt shtetit tonë në sytë e ndërkombëtarëve?

Sigurisht që konflikti institucional midis institucionit të Presidentit të Republikës dhe kryeministrit nuk është i mirë, nuk është në favor të shtetit të shëndetshëm të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare dhe për marrëdhëniet dypalëshe, por duhet të kemi parasysh që nuk është rasti i parë në Shqipëri. Përgjithësisht, me ndonjë përjashtim siç mund të ketë rasti i presidentit Mejdani thajtasë të gjithë presidentët e tjerë në mandatet e tyre kanë qenë kush më shumë dhe kush më pak në një konflikt institucional me ekzekutivin për shkak se në Kushtetutë nuk

janë të përcaktuara shumë qartë kompetencat e dy institucioneve për mjaft çështje ose se përvoja e gjithë këtyre viteve ka nxjerrë fakte të reja, ka nxjerrë politika të reja të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në Kushtetutë. Por për mendimin tim, në të gjitha rastet, por edhe tani një mirëkuptim i ndërsjellë dhe një bashkëpunim i ndërsjellë midis institucioneve, një konsultim paraprak midis tyre do të shmangte shumë fërkime dhe përplasje të panevojshme.

Ka pasur shumë debat mbi kandidaturën e zotit Cakaj të propozuar fillimisht nga Rama për ministër të Jashtëm dhe që tashmë drejton Ministrinë e Jashtme nga pozicioni i zëvendësministrit. Ju si do e vlerësonit kandidaturën e tij?

Unë nuk kam njohje nga afër për të dhënë vlerësime për cilësitë e tij profesionale. Është shpejt për ta gjykuar, do të shihet në drejtimin faktik dhe operativ të Ministrisë së Jashtme dhe pastaj do të kemi rastin për të shprehur opinionet tona. Uroj që t'i shkojnë punët mbarë, që të fshijë mëdyshjet që janë krijuar rreth emrit të tij dhe mbi të gjitha të kontribuojë në zbatimin e politikës së jashtme të shtetit shqiptar, që është një politikë që përcaktohet nga bashkëpunimi i të gjitha institucioneve të shtetit që ka Ministria e Punëve të Jashtme, qeveria, presidenti dhe Kuvendi.

Sa të drejtë e pe largimin e Bushatit në këto momente, ishte diçka e pritshme për ju?

Unë nuk jam në brendësi të punëve të qeverisë, ajo është kompetencë e kryeministrit dhe e vetë Partisë Socialiste.

Do të thosha në pikëpamjen e kreut të diplomacisë, a ishte një ministër i mirë, a punoi mirë apo keq?

Nuk jam unë ai që duhet të vendos nota vlerësimi, është kryeministri. Unë veç si koleg dhe si njëri që kam pasur kontakte ajo sa mund të ketë një ish-ministër i Jashtëm, e kam vlerësuar dhe respektuar.



Një nga protestat e opozitës

MARRËVESHJET

"Për mendimin tim, edhe marrëveshjet e rëndësishme ndërkombëtare qofshin ato dypalëshe apo shumëpalëshe, patjetër që duhet t'i nënshkruajë kryeministri që ka edhe portofolin e ministrit të Jashtëm".



Monika Kryemadhi:

16 shkurti të na bashkojë të gjithëve pa dallime politike

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi gjatë takimit me strukturat në Kavajë, u bëri thirrje qytetarëve të marrin pjesë masivisht në protestën e 16 shkurtit që organizon opozita kundër qeverisë. Kryemadhi u shpreh se situata në të cilën gjendet Shqipëria sot është alarmante dhe se largimi i kryeministrit Edi Rama është mision kombëtar. "Protestat e 16 shkurtit nuk fillon dhe nuk mbaron në 16 shkurt. Janë bizneset e vogla që po mbyllen për shkak të taksave. Është protesta e nafëtarëve, e minatorëve, e mësuesve, infermierve dhe mjekëve që po largohen nga vendi. Është protesta e pensionistëve. 16 shkurti do jetë një datë që do mblihdemi të gjithë pa dallime politike. Situata në të cilën gjendet Shqipëria është alarmante. 80% e popullit të Kavajës kanë njerëzit e tyre në emigrim. Pjesa më e madhe e familjeve mbahet me paratë e djemve emigrantë. Shqipëria hap negociatat në qershor, por që të hapen këto negociata duhet të plotësohen disa reforma", deklaroi Kryemadhi. Ajo shprehu shqetësimin se: "Çdo ditë e më shumë po e kuptojmë se problemi tek moshajpa e negociatave qëndron tek një njeri i vetëm që ka marrë peng PS dhe qeverinë dhe ky është Edi Rama. Shqipëria është një vend në mes të Evropës dhe për ta pasur Shqipërinë në BE nuk kemi zgjedhje tjetër, por të largojmë Edi Ramën. Largimi i këtij njeriu është mision kombëtar, pasi ky njeri grabit njerëzit çdo ditë".



PROTESTA

Është protesta e pensionistëve. 16 shkurti do jetë një datë që do mblihdemi të gjithë pa dallime politike. Situata në të cilën gjendet Shqipëria është alarmante. 80% e popullit të Kavajës kanë njerëzit e tyre në emigrim. Pjesa më e madhe e familjeve mbahet me paratë e djemve emigrantë.

DEKLARATA

Kompania e kërkimit të naftës, "Shell" ka deklaruar se nuk do të kryejë kërkim në zonën e mbrojtur të Zagorisë.



"Shell" tërhiqet nga kërkimet për naftë në Zagori

veçantë nga legjislacioni shqiptar", tha drejtori i kompanisë "Shell" në Shqipëri, z. Rohan D'Souza.

kishin këto punime në zonën e mbrojtur "Shell", një nga kompanitë më të mëdha globale në fushën e kërkimeve për naftën në datën 9 shkurt 2012 mori interesat e dy blloqeve ekzistuese kërkimi në tokë me vendndodhje në jug të Shqipërisë Qendrore (Blloqet 2-3) të mbajtura nga Petromanas.

Në qershor të vitit 2013, "Shell" dhe "Petromanas" ranë dakord për një kalim të dytë interesash,

i cili rezultoi në marrjen e 75% të interesave të Bllokut 2-3 nga "Shell". Në shkurt të vitit 2016, "Shell" fitoi 25% të interesave të mbetura të "Petromanas" dhe u bë operator i KNP për Blloqet 2-3 në datën 1 mars 2016.

Kreu i Zyrës së Regjistrimit të Pasurive: Brenda korrikut regjistrojmë lejet e legalizimeve

Zyra e Regjistrimit të Pasurive ka ende në proces regjistrimi 10 mijë leje legalizimi. Kryeregjistruesi Valdrin Pjetri u shpreh se qytetarët që kanë banesat në proces legalizimi do të marrin certifikatën e pronësisë brenda muajit korrik.

Legalizimet pa hipotekë, 10 mijë tapi brenda 6 muajve

Pjetri: Problem për Hipotekën, dëmtimi i dokumenteve



Foto ilustruese

Në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë 10 mijë dosje me leje legalizimi, që mbeten ende pa certifikatë pronësie. Kryeregjistruesi Valdrin Pjetri u shpreh se sfida e këtij institucioni është hipotekimi i çdo objekti që shkon përmes ALUIZNI-t.

Në inventarin fizik që ne bëmë para pak ditësh në zyrën e Tiranës rezultojnë të jenë rreth 10 mijë leje legalizimi akoma të paregjistruara. Në vitin 2018 ky stok ishte rreth 20 mijë leje, 9500 u certifikuan vitin e kaluar.

Vendimi: Tarifa zero deri në 2021 Roaming në Ballkan, kostot do reduktohen nga korriku 2019

Tarifat e bisedave në celular (roaming) mes vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6-Shqipërisë, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë, Maqedonisë, Bosnjës) pritet të reduktohen në korrik 2019 dhe të bëhen zero deri në vitin 2021.

kanëve që të finalizohet sa më shpejt që të jetë e mundur Marrëveshja Rajonale Roaming, që gjithashtu do të reduktojë më tej kostot e roaming në korrik 2019, duke hapur rrugën për "Roam Like At Home" (RLAH) dhe bërjes së kostove të roamingit zero deri në vitin 2021.

u krijua më shumë se 50 vjet më parë dhe kjo duhet të jetë një rezultat i prekshëm i RÇ. 'Roaming si në shtëpi' mundëson ndërlikime mes njerëzve, mes qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, duke shkuar drejt përfitimëve ai ato të një qytetari të zakonshëm të BE. Bashkimi Evropian iu deshën 10 vjet për të futur roaming si në shtëpi, ndërsa vendet e Ballkanit Perëndimor duhen përgëzuar për ambicion dhe guximin për të përfunduar këtë proces në pothuajse 2.5 vjet".

Në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë 10 mijë dosje me leje legalizimi, që mbeten ende pa certifikatë pronësie. Kryeregjistruesi Valdrin Pjetri u shpreh se sfida e këtij institucioni është hipotekimi i çdo objekti që shkon përmes ALUIZNI-t.

Regjistrimi në "e-Albania" Lejet e legalizimeve mund të regjistrohen në Hipotekë brenda 10 ditëve me një kosto prej 5 mijë lekësh, pa qenë nevoja të prisni ALUIZNI-n të dorëzojë dosjen në Hipotekë.



gjithë-përfshirëse e (WB6) Rajonale jo vetëm që ka një vlerë shumë të rëndësishme simbolike për rajonin, pasi ajo ndjek përafrimin me BE-në, por vlera e saj gjëron edhe në faktin se ajo gjeneron drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm ndikim, përfitime dhe kursime për të gjithë qytetarët e Ballkanit Perëndimor.

shpenzimeve të udhëtimit. Është llogaritur se kostoja e roamingit ndonjëherë është më e lartë sesa e vetë pushimeve. "Me marrëveshjen e re Roaming Rajonale nuk do të ketë shpenzime shtesë roaming për përdoruesit fondurë të të gjitha ekonomive të Ballkanit Perëndimor, duke filluar nga korriku 2021 dhe qytetarët do të paguajnë cmime njësoj si të jenë duke folur në vendin e tyre të origjinës.

SHPALLJE ANKANDI Zyra Permbartimore "E.G. Bailiff Service" me përmbartues gjyqësor Enuar Merko me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja 8, Apt 1, Tiranë, ngjalon se më datë 22.02.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet Ankandi i III-të për shpallje e pasurisë së paluajtshme. Anë, me sipërfaqe 13,000 m², Nr. pasurisë 38/10, Zona Kadastrale Nr. 1669, Vol. 5, Fq. 202, në pronësi të Z. Behar Ibrahim, Flamur Ibrahim, Arben Ibrahim, Eduan Ibrahim, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 98,280 (Nëntëdhjetë e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) EURO. Dhe Pasuri e paluajtshme. Anë, me sipërfaqe 8,200 m², Nr. pasurisë 6/4, Zona Kadastrale Nr. 1669, Vol. 4, Fq. 34, në pronësi të Z. Fatmir Kaziu, në adresën Fushë Prezë Tiranë me vlerë fillestare në ankand 115,920 (Njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e njëzet) EURO. Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, +355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, grup pune për verifikimin e 182 marrëveshjeve

Belinda Balluku: Kontratat e HEC-eve do të kalojnë në skaner

Nën kontroll, gjithë dokumentacioni dhe punimet fizike

Të gjitha kontratat koncesionare për ndërtimin e HEC-eve do të kalojnë në sitën e një grupi të ngritur dhe nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Lajmin e bëri të ditur ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Belinda Balluku, e cila deklaroi se do të ngrinin të gjitha kontratat jooperative deri në përfundim të procesit të skanimit. "Jam informuar intensivisht gjatë këtyre ditëve të para në detyrë mbi situatën dhe ecurinë e kontratave koncesionare të hidrocentraleve, të cilat janë 182 kontrata që u korrespondojnë 440 HEC-e. Sot vetëm 96 hidrocentrale janë operative. Ato u përkasin 73 kontratave koncesionare dhe kjo përbën një arsye për një vëzhgim të detajuar të të gjitha kontratave ende jooperative, në funksion të një sërë konkluzionesh të nevojshme për të gjykuar strategjinë e këtij sektori, efikasitetin e politikës së ndjekur në vite për stimulimin e HEC-eve të vegjël, impaktin ekonomik dhe social të tyre, e me radhë. Në këto kushte, kur kemi shumë më shumë kontrata ende jooperative sesa operative, është koha të bëjmë një ndalesë dhe të gjykojmë për vazhdimësinë", - tha Balluku. Ministria bëri të ditur se në sitë do të kalojë jo vetëm dokumentacioni, por do të verifikohen edhe punimet në terren. "Kam vendosur fillimin e një procesi skanimit të dokumentacionit licencues të çdo subjekti të licencuar, e po ashtu edhe skanim fizik të çdo HEC-i dhe subjekti realizues. Ky proces do të ndiqet nga një grup pune i udhëhequr nga zëvendësministri, z. Bonati, i cili ka bërë një punë voluminoze dhe të vyer në sektorin e ujit", - tha ministria e re.

KRITERET E KONTROLLIT

Ministria sqaroi se procesi do të bazohet në dy kritere, nëse kompanitë e licencuara i kanë përmbyshur kushtet teknike dhe afatet kohore si dhe kriteri i përputhshmërisë me kërkesat mjedisore. Balluku tha se gjatë kësaj kohe deri sa të kalojnë në skaner të gjitha kontratat do të pezullohen ato që janë jooperative. "Procesi në fjalë do të bazohet në dy kritere, kriteri i përputhshmërisë ligjore dhe përmbyshja e kushteve kontraktuale nga subjektet e licencuara, duke përfshirë këtu kushtet teknike dhe afatet kohore, si dhe kriteri i përputhshmërisë me kërkesat mjedisore. Ky institucion në pesë vitet e fundit ka bërë një disiplinim të madh të situatës së trashëguar, e



Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës, Belinda Balluku

HEC-et



PROBLEMET

HEC-et e vegjël kontribuojnë në ekonomi, por edhe mund të dëmtojnë ekonomikisht shumë më tepër sesa kontributi i tyre, nëse për një HEC të vogël, i bie vlera një pasurie të madhe natyrore. Ndaj, na duhet një ekuilibër perfekt mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së pasurive tona natyrore, të cilat janë pasuria më e madhe që ne shqiptarët kemi.

cila ishte skandalozë, në kufijtë e kriminale, por jo vetëm e mira s'ka fund, edhe problemet e sektorit në këtë drejtim nuk janë sosur, por janë reale e shqetësuese. Prandaj ne, gjithashtu, do të skanojmë dhe vlerësojmë nëse kontratat ekzistuese janë në përputhje me kushtet mjedisore dhe standardet e kërkuara në zonat përkatëse. Kujtoj se koncesionarët kanë detyrim të jenë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi për sa i përket mjedisit dhe kushteve mjedisore të vendosura në kontratë", - sqaroi ajo.

HEC I HOLTËS

Ministria Belinda Balluku e cilësoi të papranueshëm rastin e ndërtimit të HEC-it mbi kanionin e Holtës në Gramsh dhe tha se në bashkëpunim me ministrin e Mjedisit, Blendi Klosi do të trajtohet në formën e një diskutimi me banorët. "Nga ana tjetër, kam vendosur ngrirjen e të gjithë kontratave jooperative deri në daljen e

raportit të skanimit të tyre. Po ashtu, do të bashkërendojmë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për një qasje ligjore dhe administrative të integruar, në mënyrë që të mos përsëriten më situata ligjërish të paatakueshme, por faktikisht të papranueshme, siç është dhe rasti i fundit në Gramsh. Së bashku me ministrin Klosi do ta kthejmë rastin e Gramshit në një platformë diskutimi të hapur me komunitetin dhe do të punojmë për përmirësimin e bazës ligjore e të procedurave. Por, dua ta them shumë qartë: vërtet HEC-et e vegjël kontribuojnë në ekonomi, por edhe mund të dëmtojnë ekonomikisht shumë më tepër sesa kontributi i tyre, nëse për një HEC të vogël, i bie vlera një pasurie të madhe natyrore. Ndaj, na duhet një ekuilibër perfekt mes zhvillimit ekonomik dhe mbrojtjes së pasurive tona natyrore, të cilat janë pasuria më e madhe që ne shqiptarët kemi", - tha ministria Balluku.

Vendimet e Ballukut

Më të marrë detyrën si ministre e Energjisë dhe Infrastrukturës, Balluku shkarkoi nga detyra drejtorin i Autoritetit Shtetëror të Rrugëve (ARRSH), Afrim Qëndro, duke e zëvendësuar me ish-ministrin e Mbrojtjes së Sipërmarrjes, Sonila Qato.

Nga detyra u dorëhoq edhe kreu i OST-së, Klodian Gradeci. Vendimet vijjnë pas skandalit me kompaninë "DH Albania", e cila fitoi dy tendera me vlerë 30 milionë euro për Unazën e Re dhe për një linjë transmetimi mes Burrelit dhe Peshkopisë. Ajo po ashtu shkarkoi edhe drejtorin e Portit të Durrësit, Afrim Baka. Në vend të tij është emëruar drejtor i Autoritetit Portual Durrës, Genti Tare. Një tjetër vendim i marrë prej saj ishte edhe anulimi i koncesionit të aksit Thumanë-Kashar, paratë e të cilit siç tha ministria, do të përdoren për "Paktin për Universitetin".



Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER NOTIFICATION

**SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION
TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT**

Tirana International Airport sh.p.k is looking to contract a company for supply with fuel for airside vehicles, fuel station, for a period of two year with possibility of renewal.

The company needs to have the respective license for fuel supply, and also be equipped with it's own tanker, that will deliver the fuel to Tirana International Airport fuel station.

In order to obtain the necessary information for participating in this process, the interested parties need to write an e-mail to the following address: apalushi@tirana-airport.com; fvojka@tirana-airport.com; ialimema@tirana-airport.com specifying request for information for "Supply with Fuel for Airside Vehicles Fuel Station".

The necessary instructions are delivered free of charge, electronically through e-mail.

Offers needed to be submitted in a **closed and sealed package** clearly marked 'SUPPLY WITH FUEL FOR AIRSIDE VEHICLES FUEL STATION FOR TIRANA INTERNATIONALAIRPORT'.

The address for submission of offers is:

Tirana International Airport sh.p.k
Procurement Department
Administration Building
Rinas, Tirana
Albania

The deadline for the submission of offers at the above address is **12:00 hrs on 7 February 2019**.

Any offer submitted by open means (e.g. by e-mail, fax) will not be considered for this tender.

For further information please send an email to all the following addresses:
apalushi@tirana-airport.com
fvojka@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com



Ambientet e shtëpisë së vjetër ku kanë jetuar nënë e bijë

13-vjeçarja: Gjyshja më kërcënon me jetën e mamit. Kërkojmë një shtëpi e ushqime

Voltiza Duro

Nëna 45-vjeçare rrëfen tmerrin: Burri ngacmoi seksualisht vajzën

"Na rrihte, na torturonte e na linte pa bukë"

Ishite viti 2005 kur ajo veni dosi të martohet, por asnjëherë nuk e kishte imagjinuar që zgjedhja e saj do t'i shkatërronte jetën. Mendoi se do të niste një jetë të lumtur krahas bashkëshortit, por fatkeqësisht përfundoi në një makth nga i cili ende nuk po shkëputet dot.

Sot ajo është 45 vjeç, por vuajtjet e kanë plakur para kohe, ndërsa fuqinë për të vazhduar jetën dhe për të përballuar vështirësitë e gjen vetëm te përqafimi i ngrohtë i vajzës së saj 13 vjeçare. Kjo është banesa në të cilën nënë e bijë kanë jetuar për plot 14 vite, një ambient i zymtë, plot lagështirë, e me orendi të shkatërruara. Nëna rrëfen për News 24 historinë e trishtë e goditjet e shumta që jeta i ka dhënë për vite me radhë. "Në vitin 2005 unë jam martuar, ndërsa në 2006 kam lindur vajzën. Nuk kemi pasur as drita, as ujë, asgjë! Patëm vetëm një dhomë e pikonte çatia. Nuk kishim as bukë për të ngrënë, vajza ishte shumë e vogël dhe nuk dija çfarë të bëja. Ish-bashkëshorti im vetëm pinte dhe mua e vajzën na linte pa ngrënë. Vajza qante se donte qumësht, por unë nuk kisha çfarë t'i jepja se isha pa punë vetë", tregon 45 vjeçarja.

DHUNA NË FAMILJE
Përproblemeve të shumta ekonomike, vetëm 1 vit pas martesës, gruaja u ndesh me dhunën e bashkëshortit. Nënë e bijë ranë pre e goditjeve të pamëshirshme të njeriut më të afërt, i cili shumë herë i linte pa bukë e i nxirrte jashtë në mes të të ftohtit. "Dhunë për herë të parë ndaj meje ka ushtruar në vitin 2006. Kur vinte i pirë në shtëpi, na guante, na rrihte, na nxirrte përjashta në mes të rrugës, në mes të natës. Dhuna ka vazhduar deri sa jam divorcuar, për shumë vite për shumë vite", rrëfen gruaja.

NGACIMI SEKSUAL
Mes lotësh, 45-vjeçarja trondit me një tjetër dëshmi



Nëna 45-vjeçare me të bijën

KËRCËNIMI

"Ish-vjehrra ime na del në rrugë e na kërcënon. Kur zbrita nga autobusi më tha: Sado ta ruash vajzën ti, ne prapë do ta marrim. Kam frikë, më ka thënë që do të më vrasë e do të më varrosë. Nuk kemi mbështetje kurkund, kemi frikë të ecim në rrugë", tregon gruaja.

shokuese. Sipas saj, i ati ngacmonte seksualisht të bijën. Edhe vetë fqinjët, pohojnë jashtë kamerave të News 24 se kanë parë vetë raste kur vajza ka dalë duke qarë nga shtëpia e është ndjekur nga babai që tentonte të kryente veprime të turpshme me të. "Ai u zhvishte lakuriq, në sy të vajzës, madje zhvishte edhe vajzën. E prekte në vende që s'duhej ta prekte, dhe unë bërë denoncimin, por sërish policia nuk i mori për bazë fjalët e

mia dhe të vajzës. I thosha ta çonte vajzën në shkollë, por ai e nxirrte për të lypur që të merrte paratë e të pinte raki, e ulte në prehër bashkë me shokët e tij rrugëve", thotë duke qarë nëna e 13-vjeçares. Gjithë këto vite ishin një ferr i vërtetë për 45-vjeçaren e vajzën e saj, por pas shumë denoncimesh në polici, gruaja mori guxim të divorcohej. Ish-bashkëshorti sot ndodhet në burg e mbi të rëndon akuza për dhunë në familje. "Në 2018

ai u dënua për dhunën ndaj vajzës, thotë 45-vjeçarja.

KËRCËNIMET

Prej disa muajsh, nënë e bijë kanë marrë një shtëpi me qira, të papërbalueshme ekonomikisht për to, por e kishin të domosdoshme të largoheshin për të shmangur konfliktet dhe kërcënimet nga ish-vjehrra e 45-vjeçares. "Ish vjehrra ime na del në rrugë e na kërcënon. Kur zbrita nga autobusi më tha: Sado ta ruash vajzën ti, ne prapë do ta marrim. Kam frikë, më ka thënë që do të më vrasë e do të më varrosë. Nuk kemi mbështetje kurkund, kemi frikë të ecim në rrugë", tregon gruaja. Edhe vetë vajza 13 vjeçare pohon kërcënimet nga gjyshja e saj. "Gjyshja më ka thënë që kur të zbresi mami nga autobusi do ta

zhdukim. Unë nuk i thashë asgjë, u largova", thotë vajza. Nëna kërkon nga shteti një urdhër mbrojtjeje për veten e të bijën. "Kërkoj një zgjidhje, kërkoj një urdhër mbrojtjeje për vete e për vajzën", thekson 45-vjeçarja më tej.

APELI PËR NDIHMË

E vetmja pagesë që iu mban frymën gjallë, është rroga prej 170 mijë lekësh të vjetra që merr 45-vjeçarja nga puna si sanitare në një kompani private. Ajo tregon se qiraja e shtëpisë është 150 mijë lekë, e iu ngelen vetëm 20 mijë lekë të vjetra në muaj për t'u ushqyer. "Unë jam pastruese dhe marr një rrogë prej 170 mijë lekësh të vjetra, nga këto 150 shkon shtëpia bashkë me drita e ujë. Na ngelen vetëm 20 mijë të vjetra për të kaluar muajin, ato nuk na

DËSHMIA
"Ai u zhvishte lakuriq, në sy të vajzës, madje zhvishte edhe vajzën. E prekte në vende që s'duhej ta prekte, dhe unë kam bërë denoncimin, por sërish policia nuk i mori për bazë fjalët e mia dhe të vajzës. I thosha ta çonte vajzën në shkollë, por ai e nxirrte për të lypur që të merrte paratë e të pinte raki, e ulte në prehër bashkë me shokët e tij rrugëve", thotë duke qarë nëna e 13-vjeçares.

dalin as për të ngrënë. Nuk kam as ngrohje, asgjë e madje kam marrë edhe bukë me listë. Unë mund të haj një herë në ditë", shprehet gruaja. Nënë e bijë u bëjnë thirrje shqiptarëve që t'i ndihmojnë sadopak me ushqime për të kaluar muajin, veshje e një banesë ku të fusin kokën, për të lehtësuar sadopak vuajtjet që po kalojnë. "Kërkojmë vetëm një dhomë sa të fusim kokën e të mos lajmë qiranë e shtëpisë, dua që vajza ime të rrijë si gjithë të tjerët. Ju lutemi gjithë shqiptarëve, kush ka mundësi të na ndihmojë", thotë 45-vjeçarja. Ndërkohë vajza kërkon mjete shkollore, ushqime e rroba. "I lutem gjithë shqiptarëve që të na ndihmojnë me një shtëpi, ushqime, veshje", apelon e mitura.

Ministria: Ja kush do të ketë prioritet

Punësimi i mësuesve të shkollave profesionale, nëpërmjet "Mësues për Shqipërinë"

Punësimi i mësuesve të lëndëve të përgjithshme në shkollat profesionale do të bëhet nëpërmjet portalit "Mësues për Shqipërinë". Kjo deklaratë është bërë ditën e djeshme nga ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë, Besa Shahini, e cila ka theksuar se përparësi do të kenë kandidatët që njohin një gjuhë të huaj e kanë pasur rezultate të mira. "Do të përfshijmë në portal përfundimisht edhe punësimin e mësuesve të lëndëve të

përgjithshme në shkollat profesionale. Me një bashkëpunim të ri që kemi vendosur tani do të ndihmojmë në punësimin e mësuesve sipas rregullave që i ka portali "Mësues për Shqipërinë". Do t'i japim përparësi kandidatëve që e njohin një gjuhë të huaj dhe do t'i japim më shumë përparësi kandi-

datëve që kanë dalë mirë në rezultatet e studimeve për t'u bërë mësues", -tha Shahini në fjalën e saj. Kjo e fundit theksoi se Ministria e Arsimit është në përfundim të rregullimit të udhëzimit nr. 38 nëpërmjet të cilit do të rregullohet njëherë e mirë punësimi i mësuesve. "Jemi në proces të përfundimit të

një rregullimi të udhëzimit numër 38, që për shumicën e njerëzve që po na shohin nuk ka kuptim udhëzimi numër 38, por mësuesit e dinë shumë mirë se ky është udhëzimi më të cilin rregullohet punësimi i tyre, dhe drejtoritë arsimore, zyrrat arsimore duhet ta respektojnë me përpikëri.



Emërimi i mësuesit ndihmës, prapë do të bëhet VETËM përmes portalit. Pri-

oritet kanë mësuesit, të cilët kanë një arsimim tek pedagogjia speciale. Nëse nuk ka në portal mësues që e kanë këtë arsimim atëherë do të merren më të mirë nga cikli, i cili ka nevojë për mësues ndihmës. Nëse është cikli i ulët, mesëm ulët apo i lartë dhe merret më i miri në portal dhe kanë përparësi ata që kanë kryer një trajnim për mësues ndihmës", shtoi ministria e re e MASR. Ajo theksoi se do të ketë një riorganizim të të gjitha Drejtorive Arsimore dhe Zyrave Arsimore ku kanë pasur shumë ankesa.

Reagojnë deputetët e opozitës: Shëndetësia falas, vetëm një iluzion për shqiptarët

Urdhri i Stomatologut vendos çmime dysheme dyfish më të larta për shërbimet dentare

Ministria e Shëndetësisë: Nuk ka kompetenca për vendime të tilla

Urdhri i Stomatologut ka vendosur çmimet dysheme për shërbimet që qytetarët marrin në klinikat dentare. Por krahasuar me listën e çmimeve të mëparshme, konstatohet një rritje e tyre. Sipas listës së publikuar nga USSH, një mbushje e gradës së dytë, që përgjithësisht nëpër klinika kushton 3000 lekë, sipas çmimit dysheme nuk mund të kushtojë më pak se 4 mijë lekë. Edhe pastrimi i gurëzave, që aktualisht kryhet me 1000-2000 lekë, sipas listës nuk mund të kushtojë më pak se 3000 lekë. Menjëherë pas kësaj, ka ardhur dhe reagimi nga Ministria e Shëndetësisë e cila ka theksuar se Urdhri nuk është organi kompetent për vendosjen e çmimeve dysheme. "Pavarësisht vendimit të urdhrin për rritjen e çmimeve dysheme të shërbimeve bazë dentare, kjo nismë nuk mund të aplikohet pasi i mungojnë kompetencat vendimmarrëse", thekson Ministria e Shëndetësisë.

PËRGËNJESHTRIMI
Nërkohë Urdhri i Stomatologut ka përgënjestruar lajmin në një deklaratë për mediat duke theksuar se çmimet e publikuara janë çmime referencë dhe nuk kanë fuqi detyruese në tregun dentar. "Mbi 90% e detistisë e ushtrojnë privatisht profesionin dhe janë të lirë të ushtrojnë profesionin plotësisht të pavarur si në çmime dhe në koncept profesional. Jemi të detyruar të përgënjestrojmë një lajm të rremë dhe dashakeqës për shërbimin stomatologjik dhe Urdhri e Stomatologut për çmimet e referencës të miratuar në Asambleenë Kombëtare të Urdhrit të Stomatologut me një pëlqim paraprak



"VENDIM KORRUPTIV"
"Qeveria është bërë pjesë e një vendimi të paligjshëm dhe korruptiv, të marrë nga Urdhri i Stomatologut për thauje dyfishim të çmimit të shërbimit për qytetarët. Me një vendim të paprecedentë, të paligjshëm, abuziv, presidenti i Urdhrit të Stomatologut, Nikollë Deda. kandidati për deputet i Edi Ramës në Pukë, urdhëron dentistët të rrisin gati dyfish çmimet për 13 shërbime", - thotë deputeti i PD, Bardh Spahia.



"DUART NË XHEPAT E QYTETARËVE"
"Dyfishohen pagesat për procedurat e mirëmbajtjes së dhëmbëve dhe pajisjeve dentare! Tashmë shëndetësia falas jo vetëm që nuk ekziston, madje as në letra dhe në ëndrrat më të bukura, po tashmë shqiptarët do të mbeten pa dhëmbë në gojë! Dhe pse ndodh kjo? Se armiku kryesor i qeverisë janë qytetarët. Duke futur duart në xhepat e qytetarëve, do t'i grijë këta të fundit me dhimbje dhëmbësh", - shprehet Malaj.



"DËSHTIM I POLITIKAVE SOCIALE"
"Vendimet e Urdhrit për rritjen rreth dy herë të çmimeve për procedurat dentare nëpërmjet pagesave direkte të qytetarëve, flet për dështim të plote të politikave sociale të Rilindjes dhe të iluzionit "shëndetësi falas", për "futje duarsh" në xhepat e qytetarëve. Stomatologjia është pjesë përbërëse e sistemit tonë shëndetësor, për të cilin nuk ekziston mbulesë financiare apo sociale", - thotë Shehu.



prej pjesës dërrmuese të dentistisë shqiptare. Këto çmime referencë krijojnë një rregullsi në tregun dentar dhe mbrojnë qytetarët nga kequshtrimi profesional në dentistri. Çmimet e referencës nuk kanë asnjë fuqi detyruese në tregun dentar, por ato janë thjeshtë orientuese", -bën me dije Urdhri.

REAGIMET
Të shumta kanë qenë reagimet nga deputetët e opozitës lidhur me çmimet dysheme të përcaktuara nga Urdhri i Stomatologut. Deputetja e LSI-së, Nora Malaj ka theksuar se armiku kryesor i qeverisë janë qytetarët dhe se shqiptarët do mbeten jo vetëm pa atdhe, por edhe pa dhëmbë. "Dyfishohen pagesat për procedurat e mirëmbajtjes së dhëmbëve dhe pajisjeve dentare! Tashmë shëndetësia falas jo vetëm që nuk ekziston, madje as në letra dhe në ëndrrat më të bukura, po tashmë shqiptarët do të mbeten pa dhëmbë në gojë! Dhe pse ndodh kjo??? Se armiku kryesor i qeverisë janë qytetarët. Duke futur duart në xhepat e qytetarëve, do t'i grijë këta të fundit me dhimbje dhëmbësh", -shprehet Malaj. Edhe deputeti i Partisë Demokratike, Bardh Spahia e ka konsideruar këtë vendim si të paligjshëm dhe korruptiv. "Qeveria është bërë pjesë e një vendimi të paligjshëm dhe korruptiv, të marrë nga Urdhri i Stomatologut për thauje dyfishim të çmimit të shërbimit për qytetarët. Me një vendim të paprecedentë, të paligjshëm, abuziv, presidenti i Urdhrit të Stomatologut, Nikollë Deda. kandidati për deputet i Edi Ramës në Pukë, urdhëron dentistët të rrisin gati dyfish çmimet për 13 shërbime. Janë shërbimet që kryejnë më së shumti qytetarët, përfshirë edhe mbushjen e dhëmbëve, vënien e protezave dhe deri tek ndërhyrjet kirurgjikale. Kandidati për deputet i Edi Ramës që drejton urdhrin e stomatologëve është në shkelje të plotë të ligjit për Urdhri e Stomatologut, i cili nuk i jep asnjë të drejtë Urdhrit të vendosë çmime për shërbimin që dentistët u japin qytetarëve", -thekson Spahia. Edhe deputeti i PD, Tritan Shehu ka thënë nëpërmjet këtij vendimi kanë dështuar politikatat sociale të Rilindjes dhe iluzionit "shëndetësi falas", për "futje duarsh" në xhepat e qytetarëve. Stomatologjia është pjesë përbërëse e sistemit tonë shëndetësor, për të cilin nuk ekziston mbulesë financiare apo sociale. Edhe mbulesa nga buxheti i urgjencës stomatologjike si dhe i parandalimit, të detyrueshme këto nga ligji, janë shumë larg reletetit dhe të veshura me shumë dyshime korruptive në aplikim", thotë Shehu.

Grëfhet modelja: Ja për çfarë nuk kursehem, reagimet e mia kur marr komplimente

Modeling dhe biznes, formula e suksesit që ofron Lorela Haka

"Shqipëria nuk të ofron të ardhura përmes pasarelave"

Egla Xhemali

Kur Zoti t'i fal të dyja, bukurinë dhe zgjuarsinë. Me të takohemi në pasarelat plot drita, ku me elegancë, sharm e stil bënë parakalimin magjik për shikuesit. E kemi fjalën për Lorela Hakën, një nga vajzat që premtim shumë për botën e modelingut. Për "Gazeta shqiptare" bukuroshja ndan pasionin e madh që ka për pasarelat, ndjesitë dhe reagimet që merr kur është me Anxhelën, binjaken e saj, rugën e biznesit me dyqanin e fustaneve, sugjerimet që u bëjnë vajzave, arsyen pse nuk kursehet si dhe detaje përtej shkëlqimit në pasarelë. Lorela dhe Anxhela plotësojnë njëra-tjetrën si në momentet e pozave, ashtu edhe në biznes. Binjaket më të dashura për publikun kanë një vit që përmbyshin ëndrrat e vajzave që duan të duken të veçanta në raste gëzimesh. Ato vijnë me një sërë surprizash për këdo që u beson fantazinë. Më tej, Lorela na lë të kuptojmë se pas gjithçkaje që duket mes ngjyrave, qëndron një shpirt i qeshur që rëndet drejt mirësisë. Ata që e duan atë që bëjnë janë të destinuar të prekin fitore, kështu që dhe binjaket modele i presin hapa të suksesshëm.

Si ka nisur eksperiencën jote në fushën e modelingut?

Së pari, të falënderoj për intervistën. Sa për modelingun, fillesat i kam pasur në



moshën 17 vjeçe, ku u bëra pjesë e një spektakli misesh, duke u kurorëzuar me vendin e dytë. Më pas rrugët mu hapën, duke njohur shumë njerëz të kësaj fushe, që më kanë dhënë mundësinë të jem pjesë e shumë reklamave, 'photoshooting' etj. Por, që dëshira ime për modelizim i ka pasur fillesat shumë më para, kur luaja misesh me motrat. (qesh)

Të qenurit model në Shqipëri mund të themi se ka një konotacion disi delikat, si përballësh ti me këtë realitet?

Faktikisht ka, sepse nuk shikohet si një profesion, shpesh të paragjykojnë si mendjelehtë dhe për një va-

jsë që është e zonja t'i bëjë të dyja edhe shkollën, edhe hobin nuk duhet të cilësohet e tillë. Unë personalisht në çdo intervistë që kam dhënë e kam prezantuar veten si studente, sepse dhe të quhesh modele duhet një punë e gjatë për ta marrë atë titull.

Sa fitimprurës është modelingu?

Shumë herë është thënë që Shqipëria nuk ta jep mundësinë të krijosh të ardhura nëpërmjet modelingut, sepse nuk është një punë stabël, që fiton rregullisht.

Mes 'photoshooting' dhe pasarelës, cilën do zgjidhje? Të dyja janë pasioni im, por padyshim veçoj pasarelat. Aty mund të çliroj çdo ek-



spressivitet, pa menduar për asgjë tjetër. Është një moment ku ndihem shumë e veçantë dhe e sigurt në atë që bëj.

Ti dhe Anxhela ndani të njëjtin pasion. Çfarë ndjesie përjeton kur pozoni bashkë?

Po, është e vërtetë. Ne kemi nisur bashkë, edhe pozën tonë të parë, përpara aparatit profesional e kemi bashkë. Është gjithmonë një emocion më vete, sepse kur pozojmë bashkë, do të thotë që diçka e re dhe inovative po vjen. Mund të pozojmë shumë identike, ose shumë të kundërta në paraqitje.

Reagimi i parë që bën kur ju thonë "sa të bukura këto binjaket"?

Sigurisht një kompliment është gjithmonë i mirëpritur dhe jemi falënderuese. (qesh)

Tanimë i jeni futur dhe botës së biznesit. Kush është menaxhere më e mirë, ti apo Anxhela?

Po, po bëjmë një vit tashmë që kemi hapur një dyqan 'online' me fustane mbrëmjesh për të gjitha vajzat që janë në dilema se çfarë të veshin në mbrëmjet e tyre që të duken më të bukura. Të dyja punojmë fort për këtë. Anxhela merret më tepër me përgjegjësinë e modeleve të fustaneve, ndërsa unë me marketingun dhe klientët, duke qenë se edhe po studioj në këtë fushë.

Të rehat e fundit që do zbulosh për publikun?

I fttoj të gjitha vajzat t'i bëjnë 'follow' faqes sonë në "Instagram", "Angel Lorel Dresses", sepse do të sjellim modele nga më të ndryshmet të fustaneve.

Disa nga sugjerimet që u

bëni vajzave për fustanet që gjenden tek ju?

Shumica e tyre e kanë zgjedhur modelin kur na shkruajnë, por ka edhe të tjera që janë ndoshta të paqarta se çfarë duan dhe ne i këshillojmë sipas gustos dhe masave trupore më të përshtatshmin për to. Për ne rëndësi më të madhe ka që klientja jonë të mbetet e kënaqur dhe të vijë sërish në "Angel Lorel Dresses".

Përtej shkëlqimit të pasarelës, si është Lorela?

Unë studioj në vitin e fundit master në degën "Menaxhim - marketing" në Fakultetin Ekonomik dhe sigurisht punoj edhe me fustanet që i përmenda më lart. Për momentin kam më të rëndësishme punën dhe shkollën dhe jam fokusuar që të dal me rezultate të mira, duke u larguar pak nga modelizimi.

Një lloj kokteili që do kishte emrin tënd, me çfarë shije do ishte?


Hmm, i ëmbël me të gjitha llojet e frutave që ekzistojnë, që të të japë energji dhe të të bëjë të buzëqeshësh pa fund.

Për çfarë nuk kursehesh?

Nuk kursehem kurrë për flokët që t'i kem gjithmonë të rregullta dhe të kuruara mirë, sepse për mua flokët janë gjysma e bukurisë së një femre.


Të rehat e fundit që do zbulosh për publikun?

I fttoj të gjitha vajzat t'i bëjnë 'follow' faqes sonë në "Instagram", "Angel Lorel Dresses", sepse do të sjellim modele nga më të ndryshmet të fustaneve.



Kush i mungon caq shumë Era Istrefit? Këngëtarja i vuri të gjithë në dyshime

Këngëtarja e njohur, Era Istrefi është drejt përfundimit të xhirimeve të këngës së saj më të re, që do ketë në bashkëpunim me motrën e saj, Norën. Xhirimet po bëhen në Kosovë, vendlindjen e këngëtares dhe projekti i ri pritet të publikohet së shpejti. Mirëpo edhe pse është shumë e angazhuar me projektet e saj, Era Istrefi ka na treguar se ndihet e vetmuar. Këngëtarja Era Istrefi, që po e shijon suksesin e saj ndërkombëtar ndjen mungesën e dikujt. "Dua që ti të jesh këtu" shkruan bashkangjitur fotos së fundit të publikuar në "Instastory", por se kush është personi që i mungon, nuk e dimë ende.



"Stop këngëve që promovojnë drogën", zbuloni shpërthimin e Tainës

Reperja Tayna pa veten në një kronikë lajmesh ku me titra shkruhej: "Stop këngëve që promovojnë drogën". Ajo shprehet se këngëtarët argëtojnë të rinjtë dhe se vendi ka probleme më të mëdha se kaq. "...Ne vetëm këndojmë dhe mundohemi të argëtojmë popullin. Unë vetë nuk përdor asgjë nga këto, madje as duhanin që shumica juaj e pi, nuk e konsumoj, që gjithashtu është i dëmshëm. Kush do ta përdorë, ne nuk e ndalojmë dot. Kush nuk do, nuk ia japim me zor. Tek e fundit, nuk kemi rolin e prindërve për të edukuar askënd. Ky është vetëm një zhanër i muzikës që ka tema të tilla e dëgjohej prej atyre që e pëlqejnë. Ju jeni rritur me muzikën rok që po ashtu ka pasur të tilla tema. Nuk duhet të merret personale asgjë që thuhet në tekstet e këngëve", shkruante Tayna në "Instagram".



Luana, shifra marramendëse për blerjet, ja për çfarë bëhet fjalë

Shpeshherë ajo vihet në fokus të mediave rozë për pamjen e saj të jashtme. Luana Vjollca nuk stepet ndaj ndryshimeve drastike në pamje dhe këtë e kemi vënë re dhe me ndryshimet e here pas hershme të ngjyrës së flokëve. Por edhe veshjet e saj e tregojnë gjithmonë në superformë dhe vlen të thuhet se ka shumë veshje



jo shumë të shtrenjta, shumë nga fustanet e saj nuk kapin vlera marramendëse, por maksimumi shkon te 100 euro. Mirëpo njëlloji si vajzat e "showbiz"-it edhe Luana ka qejf të ketë veshje të shtrenjta, të cilat nuk është se mungojnë në garderobën e saj. Vlen të përmendim se së fundmi në një postim ranë në sy atletet e saj të firmës "Louis Vuitton", të cilat duket se kushtojnë pak si shumë. Vlera e tyre kap shifrën prej 790 . Pra, duhet të themi se Luana di ku investon, pra shpenzon me mend dhe jo kot!



Arbana Osmani "tërbohët", mësoni veprimi e moderators që i habiti të gjithë

Qarkullon prej ditësh lajmi se moderatorja Arbana Osmani është ndarë nga bashkeshorti i saj pas një lidhjeje martesore 16-vjeçare, e madje thuhet se ai është larguar fare nga Shqipëria, duke marrë rrugën e gjatë të Amerikës! Arbana vetë ka preferuar të mos reagojë ndaj këtyre pretendimeve e as ndaj kritikave që i janë bërë për emisionin. Dhe së fundmi Arbana është parë për "7 palë qejfe" pasi është shfaqur duke kënduar e kërcyer në ditëlindjen e njëjës prej bashkëpunëtoreve të saj. E sigurisht këto pamje ishin pjesë e lajmeve në të gjitha portalet e ndryshme. Mirëpo Arbana nuk i mbajti shumë në "Instastory"-n e saj dhe i fshiu pa kaluar ende 24 orë. Pse vallë?



Marrëveshja e Prespës, Karamanlis: Duhet të respektojmë qytetarët

Sot zhvillohet votimi, ish-kryeministri thirrje qeverisë greke: Jo klimë përcarëse

Vijojnë debatet lidhur me marrëveshjen e Prespës. Në Athinë po protestohet prej 3 ditësh, ndërsa dje policia ka forcuar masat e sigurisë, duke mbyllur edhe disa rrugë. Ish-kryeministri grek, Kostas Karamanlis ka kërkuar nga qeveria që të respektojë ndjeshmëritë dhe shqetësimet e shumicës dërrmuese të qytetarëve. Në një deklaratë për gazetën "Kathimerini", ai komenton Marrëveshjen e Prespës, e cila do votohet sot nga qeveria greke. "Siç e kam theksuar tashmë, zonja Bakoyannis ka përkrahur me saktësi politikën e qeverisë së atëhershme, e cila çoi në vendimin e Samitit të NATO-s në Bukuresht. Një vendim që ofroi një avantazh negociues shumë efektiv në ven-



KOSTAS KARAMANLIS

"Qeveria ishte e detyruar të respektojë ndjeshmërinë dhe për të dëgjuar shqetësimet legjitime të shumicës dërrmuese të qytetarëve, por edhe për të formuar nismën e vetë kushtet e saj elementare të kuptuarit kombëtare. Nuk lejohet që çështjet kombëtare të një rëndësie të tillë të çojnë në aciditet që favorizon një klimë të përcarëse", - ka thënë Karamanlis.

nevojshëm dhe kur, natyrisht, të tjerëve u kërkohet të zgjidhin çështjen. Por sigurisht jo Greqia. Së fundmi, qeveria ishte e detyruar të respektojë ndjeshmërinë dhe për të dëgjuar shqetësimet legjitime të shumicës dërrmuese të

qytetarëve, por edhe për të formuar nismën e vetë kushtet e saj elementare të kuptuarit kombëtare. Nuk lejohet që çështjet kombëtare të një rëndësie të tillë të çojnë në aciditet që favorizon një klimë të përcarëse", shkruhet në

gazetën Kathimerini. Parlamenti grek do të votojë ditën e sotme marrëveshjen historike të Prespës, që i jep fund kontestit për emrin e Republikës së Maqedonisë. Që marrëveshja të kalojë duhen 153 vota, nga 300 deputetët që ka parlamenti vendas. Kundërshtarët e marrëveshjes kanë bërë thirrje për një protestë të re ditën e sotme. Për këtë arsye, autoritetet urdhëruan mbylljen e stacionit të metrosë në sheshin Syntagma, ndërsa 2.000 policë u mobilizuan për ruajtjen e sigurisë të parlamentit dhe objekteve të tjera qeveritare në afërsi të sheshit. Një tjetër protestë, e zhvilluar para katër ditësh, u shënuar nga përlëshje të ashpra midis policisë dhe grupeve ekstremiste që tentuan të futeshin në godinën e parlamentit.



Dyshohet për vrasjen e Ivanoviç, urdhërarrest për Milan Radojčić

Prokuroria Speciale ka lëshuar urdhërarrest për Milan Radojčić, i cili dyshohet për përfshirje në vrasjen e politikantit serb Oliver Ivanoviç. Ndërsa pritet që brenda ditësh, të lëshohet edhe urdhërarrest ndërkombëtar. Prokurori i rastit, Sylë Hoxha ka konfirmuar për gazetën 'Express' se në fillim të kësaj jave është lëshuar urdhërarrest ndaj nënkryetarit të Listës Srpska, Milan Radojčić. "Po mund të ju konfirmoj që Prokuroria Speciale e Kosovës më datë 21 janar ka lëshuar urdhërarrest vendor për Milan Radojčić, si të dyshuar për përfshirje në rastin e Oliver Ivanoviçit", ka thënë Sylë. Ndërsa, brenda pak ditësh pritet që ndaj nënkryetarit të arratisur të Listës Srpska, të lëshohet urdhërarrest ndërkombëtar. "Prokuroria në bazë të kompetencave të saja pritet që së shpejti të lëshojë urdhërarrest ndërkombëtar", ka thënë Sylë. Radojčić, i cili konsiderohet si njeriu më i fuqishëm i Veriut, ka qenë target në një operacion të kryer nga njësi të speciale të Kosovës në orët e para të mëngjesit të 23 nëntorit. Zyrtaftri i lartë i Listës Srpska, që cilësohet si i dyshuari kryesor në rastin e Ivanoviçit, ishte arratisur, ndërsa policia arrestoi tre të tjerë, të cilët po mbahen në paraburgim. Në mesin e të arrestuarve është Marko Rosiq, pjesëtar i Policisë së Kosovës, dhe Ndeljko Spasojeve e Dragisha Mirkoviç. Ndërsa dy ditë pas kësaj bastisjeje, Radojčić u shfaq në publik nga Beogradi dhe tregoi se ndodhej në Serbi. Tutje, ai po organizonte disa tubime në fshatrat me shumicë serbe në Kosovë, mirëpo vetë nuk u duk asnjëherë. Ditë më parë, prokurori Hoxha ka thënë në Televizionin 7 se të gjitha provat e siguruar nga Prokuroria Speciale tregojnë se Radojčić është përfshirë në vrasjen e Ivanoviçit. Oliver Ivanoviç, ish-ministër dhe ish-deputet në Kuvendin e Kosovës ka udhëhequr SDP-në, ndërsa u vra më 16 janar të vitit 2018.

Daçiq: Të gjendet kompromisi, s'ka dy zgjidhje në dialogun me Serbinë

Merkel: Ndryshimi i kufijve të Kosovës, i papranueshëm për Berlinin

Ekipi Negociator kosovar: Ende asnjë takim me palën serbe

Pas takimit me Vuçiq ditën e djeshme, Kan celarja gjermane ka thënë se ndryshimi i kufijve të Kosovës është i papranueshëm për Berlinin. Këtë deklaratë, Angela Merkel e ka shprehur në Davos të Zvicrës. Sipas "Koha Ditore", nga burime të sigurta, takimi i mbajtur në margjinat e Forumit Botëror Ekonomik të Davosit është shfrytëzuar nga Kancelarja gjermane mes të tjerash për t'ia qartësuar presidentit serb se pozicioni gjerman rreth dialogut Kosovë-Serbi dhe marrëveshjes së paralajmëruar përfundimtare nuk ka ndryshuar. Një burim i mirinformuar i ka thënë gazetës se në takim Merkel i ka kujtuar Vuçiqit pozicionin e Berlinit se ndryshimi i kufijve të Kosovës është i papranueshëm. Korrigjimi i kufijve apo këmbimi i territoreve është i papranueshëm për qeverinë gjermane, ka thënë burimi. Ndërkaq Ekipi Negociator Qeveritar i Kosovës i formuar para më shumë se një muaji asnjëherë nuk ka arritur të takohet deri më tani me palën serbe në kuadër të dialogut që po zhvillohet në Bruksel. Pengesë për një takim të tillë vlerësohet taksas prej 100 për qind. Pavarësisht presionit nga bashkësia ndërkombëtare që taksas ndaj produkteve serbe të hiqet sa më parë, qeveria e Kosovës po vazhdon të deklarojë se tarifa në fjalë do të mbetet në fuqi derisa Serbia ta njohë Kosovën si shtet të pavarur dhe sovran. Ndonëse pala serbe tashmë ka bërë të ditur se nuk do ta vazhdojë dialogun pa u shfuzuar taksas ndaj produkteve serbe, Ekipi Negociator, i cili është propozuar nga qeveria, ka paralajmëruar se shumë shpejt do ta dërgojë në Kuvendin e Kosovës platformën për negociatat me Serbinë, shkruan gazeta "Zëri". Por njohësit e çështjeve politike vlerësojnë se



Kancelarja gjermane Angela Merkel

Delegacioni Shtetëror mbetet krejtësisht i kotë në qoftë se njohja e Kosovës nga Serbia kushtëzohet të ndodhë me heqjen e taksës. Kjo pasi sipas tyre një gjë e tillë, që Serbia ta njohë Kosovën, mund të arrihet vetëm nëpërmjet dialogut. Nga ana tjetër, kur ende nuk është gjetur një gjuhë e përbashkët mes Prishtinës dhe Beogradit, ministri i Jashtëm Ivica Daçiq deklaroi se Serbia nuk mund të tregojë planet që ka për Kosovën. "Nuk mund që në detaje të tregojë se cili është plani serb në dialogun me Beogradin dhe Prishtinën, për zgjidhjen e problemit të Kosovës. Presidenti Vuçiq prezantoi parimet mbi të cilat duhet të diskutohet (me

Prishtinën), por sapo erdhin ideja për publikun, në një farë mënyre u bllokua dialogu", tha Daçiq, shkruajnë mediat serbe. Sipas tij Serbia synon që të gjendet një zgjidhje kompromisi mes dy vendeve. "Vendet që e kanë njohur Kosovën interpretojnë se Kosova ka kufijtë e saj, ndërsa qëndrimi ynë publik dhe Kushtetuta thonë se Kosova është pjesë e Serbisë. Në qoftë se ju thoni se ka dy zgjidhje kryesore, njëra se Kosova duhet të jetë e pavarur dhe tjetra se ajo duhet të ketë shkallën më të lartë të autonomisë në kuadër të Serbisë, do të shihni se asnjëra zgjidhje nuk është e pranueshme për të dyja palët", thuhet më tej në reagimin e tij.

Kosova porositi Bosnjën: Tarifa 100% nuk hiqet

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës, Endrit Shala ka konfirmuar për Radion "Evropa e Lirë" se disa ekspertë, të deleguar nga drejtuesi i kësaj ministrie do të jetë në Bosnje-Hercegovinë për të marrë pjesë në një takim të thirrur nga autoritetet e Bosnjës meqë këto të fundit kanë kërkuar konsultime me zyrat e MTI-së. "Në këtë takim delegacioni do të sqarojë para autoritetëve të CEFTA-s dhe të Bosnjës, si kërkuese e këtij takimi, se pse Kosova ka vendosur këtë masë dhe pse kjo masë do të vazhdojë të mbetet në fuqi. Një masë të tillë e përcallon dhe e parasheh edhe marrëveshja e CEFTA-s, e cila thotë se shtetet anëtare kanë të drejtë të marrin masa të tilla në rast se u rrezikohet siguria kombëtare. Në këtë rast Serbia dhe Bosnja e kanë rrezikuar sigurinë kombëtare të vendit tonë. Këto dy shtete me veprimtarinë e tyre çdo ditë kanë tentuar ta zhënjë vetë genien e shtetit të Kosovës", ka thënë Shala. Qeveria e Kosovës më 6 nëntor të vitit që lëmë pas ka vendosur taksë doganore 10 për qind për produktet e importuara me origjinë nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina. Kjo taksë doganore është ngritur në 100 për qind më 21 nëntor. Përveç kësaj, më 28 dhjetor, qeveria e Kosovës ka marrë vendim që të vendosë taksë doganore 100 për qind edhe për produktet e importuara nga brendet ndërkombëtare që prodhohen në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë. Mekanizmi ndërkombëtarë, si Komisioni Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë duke kërkuar në vazhdimësi heqjen e kësaj mase.



Trump: Nëse Maduro ushtron forcë, do përdorim të gjitha mundësitë

Kaos në Venezuelë, në prag të luftës civile

Shqipëria dhe Kosova njohin Guaidon si presidentin e ri

Protestat e opozitës kundër regjimit të Nikolas Maduros në Venezuelë u shoqëruan me përleshje të forta me policinë të mërkurën në mbrëmje. Rrugët u kthyen në skena përleshjesh massive. Të paktën 14 persona mbetën të vrarë dhe qindra të tjerë u plagosën. Vendi praktikisht ndodhet në prag të luftës civile. Presidenti Maduro ndërpreu marrëdhëniet diplomatike me Uashingtonin dhe akuzoi Shtetet e Bashkuara se po kryejnë një grusht shteti, duke urdhëruar dëbimin e diplomatëve amerikanë nga vendi. Në të njëjtën kohë lideri i opozitës Huan Guaido u vetëshpall President i përkohshëm i vendit. Presidenti amerikan, Donald Trump, bëri të ditur se një zyrtarisht Huan Guaidon si President të përkohshëm të Venezuelës dhe u bëri thirrje edhe krerëve të tjerë të shteteve të mbështesin presidentin e ri. Por ndryshe nga Shtetet e Bashkuara dhe aleatët e saj kryesore në Amerikën Latine, Bashkimi Europian ka shmangur njohjen e Juan Guaidó si President të Përkohshëm të Venezuelës. "Bashkimi Europian bën thirrje për një proces politik që do të çojë në zgjedhje të lira dhe të besueshme, siç parashihet me rendin kushtetues", thuhet në një deklaratë të shefes së diplomacisë evropiane, Federica Mogherini. Shkalla e lartë e papunësisë, ndërprerja e energjisë elektrike, mungesa e sendeve bazë të jetesës kanë shtyrë miliona njerëz që të braktisin vendin dhe të emigrojnë drejt Shteteve të Bashkuara. Në tubimin e së mërkurës, mijëra venezuelianë morën pjesë në tubim në mbështetje të Juan



Lideri i opozitës venezueliane, Huan Guaido

DONALD TRUMP

"Nuk kemi marrë asgjë në konsideratë, por të gjitha mundësitë janë në tavolinë. Të gjithë mundësitë, gjithnjë, të gjitha mundësitë janë në tavolinë. Venezuelasit kanë vuajtur prej shumë kohësh nga duart e regjimit të paligjshëm të Maduros", tha Trump.

Guaido. Ai u tha qytetarëve se protestat do të vazhdojnë deri sa "Venezuela të çlirohet". Guaido u betua përpara turmës dhe tha: "Beto-hem që formalisht të marr përsipër kompetencat ekzekutive kombëtare si President i përkohshëm". Ai u zotua se do të drejtojë vendin me një

qeveri të përkohshme deri në organizimin e zgjedhjeve të lira. Presidenti amerikan Donald Trump e njohu Juan Guaido si President të përkohshëm të Venezuelës. Presidenti amerikan, Donald Trump ka theksuar se çdo opsion është në tavolinë nëse regjimi i Maduros

do të përdortë dhunën ndaj opozitës. "Nuk kemi marrë asgjë në konsideratë, por të gjitha mundësitë janë në tavolinë. Të gjithë mundësitë, gjithnjë, të gjitha mundësitë janë në tavolinë", deklaroi Trump para gazetarëve në Shtëpinë e Bardhë. "Venezuelasit kanë vuajtur prej shumë kohësh nga duart e regjimit të paligjshëm të Maduros", shtoi Trump pak casto më vonë në një mesazh në "Twitter" ndërkohë që shefi amerikan i diplomacisë Mike Pompeo i bëri thirrje drejtpërdrejtë Nicolas Maduro që të largohet. Pasi kreu i opozitës së Venezuelës, Juan Guaidó u shpall President i përkohshëm,

FEDERICA MOGHERINI

"Bashkimi Europian bën thirrje për një proces politik që do të çojë në zgjedhje të lira dhe të besueshme siç parashihet me rendin kushtetues"- thuhet në një deklaratë të shefes së diplomacisë evropiane, Federica Mogherini.

vjen një reagim nga kryeministri Edi Rama. Përmes një postimi në Twitter, kreu i qeverisë pohoi se Shqipëria e njëjta Guaidon si kreun e shtetit të Venezuelës. "Shqipëria njohu Juan Guaidó si Presidenti të Përkohshëm të Venezuelës. Në emër të popullit të Shqipërisë i uroj venezuelianëve të guximshëm që të kenë sukses në zhdukjen e paligjshëm që ka kthyer vendin në ferr për popullin", shkruan Rama. Pas Shqipërisë, edhe Republika e Kosovës njohi zyrtarisht kreun e opozitës, Juan Guaido si president të përkohshëm të Venezuelës. Ky fakt u bë i ditur nga ministri i Punëve të Jashtme të Kosovës, Behgjet Pacolli.

SHKURT

Zhduket pa gjurmë futbollisti, hipoteza e re për rrëzimin e avionit

Kanë vazhduar pa sukses kërkimet për udhëtonte futbollisti Emiliano Sala. Asnjë gjurmë nuk është gjetur, ndërsa shpresat për të gjetur të mbijetuar janë thuar se zero. Ekspertët të aviacionit kanë thënë se aeroplani mund të jetë rrëzuar për shkak të akullit në krahë, duke i bllokuar kësh-tu pjesët e sistemit të drejtimit. Aeroplani i tipit Piper Malibu, me dy persona në bord, ishte nisur nga Nantes dhe do të udhëtonte drejt Cardiff, kur u zhduk mesnatën e së hënës. Para se të humbiste nga radari dhe të shkëputte komunikimet në radio me kullën e kontrollit, avioni i vogël kishte zbritur në një lartësi 700 metra. Para se avioni të humbiste, futbollisti Sala u dërgoi një mesazh zazor shokëve të tij, të cilëve u thoshte se kishte frikë dhe se aeroplani po dridhej. Kushtet e motit në hapësirën ku avioni fluturo-nte ishin të këqija. Autoritetet kanë thënë se është pamundur që dikush të mbijetonte në ato kushte, ku era është shumë e fortë ndërsa deti është i trazuar. Megjithatë, nuk është gjetur asnjë pjesë e avionit të rrëzuar. Ajo që do të përcaktojë shkaqet e rrëzimit, do të jetë kutia e zezë nëse do të gjendet.

Vuante nga diabeti, nëna s'i jep dot lamtumirën djalit

Një nënë mori avionin për të shkuar drejt Nju Jork-ut, pasi djali i saj ishte sëmurë, por ishte tepër vonë. Shaun Dobinson, 21 vjeç, nga Uashingtoni vdiq nga komplikimet për shkak të diabetit, teksa kishte shkuar me pushime në Nju Jork. Inxhinierit elektrik kishte planifikuar një udhëtim së bashku me shokun e saj të fëmijërisë. Gjendja e Shaun mori një kthesë dramatike, teksa po qëndronte në dhomën e hotelit. Ai kishte të vjella dhe nuk mund të dilte dot nga dhoma. I riu i dërgoi një mesazh nënës se tij, se ishte i frikësuar nga kjo që po i ndodhte. Pas analizave të kryera i riu kishte dalë me diabet, por gjendja e tij u përqësua shumë brenda pak ditëve. Sipas motrës së Shaun mjeku që e ka vizituar 21-vjeçarin nuk i ka thënë atij se duhet të niste trajtimin me insulinë menjëherë sapo u diagnostikua me diabet. Mjeku ka thënë se nuk e dinte që Shaun do të udhëtonte drejt Nju York-ut. Ndërsa motra e tij pretendon të udhëtonte, duke thënë se mjeku e dinte që ai do të shkonte në Nju York, por thjesht doktori nuk i ka thënë të mos udhëtonte. Mesazhi i fundit që Shaun i dërgoi nënës se tij ishte: "Të dua shumë, do më mungosh".

Spanja në ankth, shpëtimi i 2-vjeçarit në fazën finale

Prej 11 ditësh vogëlushi i bllokuar në pus, skuadra e shpëtimit në fund të procesit

Është në fazën finale procesi i nxjerrjes nga pusi 100 metra i thellë i vogëlushit 2-vjeçar nga skuadra e shpëtimit. Ata janë shprehur se do të mund të arrijnë vogëlushin "në një kohë shumë të shkurtër". Punimet e mëngjesi të djeshëm për të pasur akses në platformë thuhet se kanë shkuar mirë, dhe se shpejti do të lejohen personat e specializuar të zbrisin 60 metra për të arritur djalin. "Tani thjesht duhet të kontrollojmë pajisjet, të cilat skuadra do përdorë për shkuar në nëntokë dhe të sigurohet që çdo gjë është në rregull", u shpreh një anëtar i



SKUADRA E SHPËTIMIT

"Tani thjesht duhet të kontrollojmë pajisjet, të cilat skuadra do përdorë për shkuar në nëntokë dhe të sigurohet që çdo gjë është në rregull", u shpreh një anëtar i skuadrës së shpëtimit për një media spanjolle.

skuadrës së shpëtimit për një media spanjolle. 11 ditë më parë, vogëlushi Julen ra në pusin e thellë me diametër vetëm 25 centimetra në Totalan, 20 km larg Malagës, dhe prej asaj dite nuk janë gjetur shenja jete. Prindërit e tij ishin në një drekë familjare dhe vogëlushi ishte shkëputur vetëm për pak duke luajtur me fëmijët e tjerë në kodër. Fillimisht ekipet e shpëtimit punuan për ndërtimin e dy tuneleve paralele me pusin, një në të majtë e një në të djathtë, me rreth tre metra distancë dhe më pas gërmuan edhe për një tunel horizontal.

Opinion i Ditës

Pse Zelanda e Re i ka sytë nga Europa

Rregullat dhe normat globale janë përsëri nën kërcënim dhe bashkëpunimi në përbashkjen e sfidave më të mëdha në botë është ngurrues. Për këtë arsye, lidhjet e ngushta dhe të gjata të Zelandës së Re me Europën janë shumë të rëndësishme për çështjet që variojnë nga ndryshimet klimatike e deri te tregtia.

Nga Jacinda Ardern *

Shumë pak vende janë aq larg sa është Zelanda e Re. Çdo vit, bukuria e largët e vendit tonë tërheq miliona turistë që kërkojnë të arratisen midis peizazheve unike dhe të paprishura. Por distanca jonë fizike nga pjesa tjetër e botës i jep gjithashtu Zelandës së Re një kuptim të veçantë të komunitetit dhe lidhjes që ka rëndësi të madhe sot.

Për ne, partneritetet ndërkombëtare me ata që ndajnë angazhimet tona - të drejtat e njeriut, shoqëritë dhe ekonominë e hapura, tregtia gjithëpërfshirëse dhe drejtësia sociale - nuk janë as të domosdoshme, as të detyrueshme. Ato janë tepër të rëndësishme për mbijetesën tonë si një shtet ishull dhe integrale për atë që ne jemi.

Bashkimi European u themelua bazuar në të njëjtat parime. Pra, në kohët sfiduese të ditëve të sotme, nuk është habi që Zelanda e Re i kthen sytë nga BE-ja si një partner i natyrishtë në shumë çështje globale.

Kjo ndjenjë lidhjeje i ka rrënjë në histori. Shumë mijëra të rinj nga Zelanda e Re me dëshirë udhëtuan në anën tjetër të botës për të luftuar përkrah aleatëve tanë në dy luftëra botërore. Lufta e Parë Botërore la një shenjë të zymtë në vendin tonë, me tre në çdo pesë burra që luftuan në atë konflikt të plagosur ose të vrarë.

Zelanda e Re nuk e ka harruar kurrë atë humbje tragjike dhe mësimet që dolën nga kjo gjë. Ne mësuam se një botë pa rregulla, ose pa mjete paqësore për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, është një botë në kaos dhe ku derdhet gjak. Mësuam se edhe vendet më të vogla kanë rolin e tyre në ndërtimin dhe mbrojtjen e botës në të cilën ata dëshirojnë të jetojnë. Dhe mësuam të ishim mbrojtës të ashpër të dialogut, diplomacisë dhe sundimit ndërkombëtar të ligjit dhe pjesëmarrësve entuziastë në institucionet e qeverisjes globale dhe paqes.

Sot, me rregulla dhe norma globale përsëri nën kërcënim, dhe bashkëpunimi në përbashkjen e sfidave të mëdha në botë, vendet si i yni duhet të punojnë akoma më ngushtë me ata që janë të angazhuar për të njëjtat vlera thelbësore. Në këtë drejtim, Zelanda e Re e sheh BE-në dhe shtetet e saj anëtare si partnerë kryesorë në tri çështje në veçanti: ndryshimet klimatike, promovimin e paqes dhe stabilitetin global dhe tregtisë.

Ndryshimi i klimës është sfida përcaktuese globale e kohës sonë. Ne po punojmë së bashku me partnerët tanë të BE-së për të vendosur



sur objektiva ambicioze për uljen e emisioneve dhe për shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës që do të mbështesë nisja të brendshme për të përbashkër

këto objektiva.

Zelanda e Re dhe BE-ja po bashkëpunojnë gjithashtu për të ndihmuar vendet më të prekshme dhe më të prekura në botë që të përsh-

taten me efektet e ndryshimeve klimatike dhe për t'i bërë të mundur ata të zhvillojnë dhe të arrijnë standardet më të larta jetese në mënyrë të qëndrueshme. Për shem-

bull, në Paqësor ne kemi punuar së bashku për të mbështetur përdorimin në rritje të energjisë së rinovueshme. Kjo ka zvogëluar varësinë nga lëndët djegëse fosile dhe ka bërë që komunitetet të jenë më elastike në aspektin ekonomik, duke lehtësuar kështu progresin e rajonit drejt përbashkjes së qëllimeve të tij të ndryshimit të klimës.

Partneriteti ynë në fushën e paqes dhe stabilitetit global është po aq i vlefshëm. Ne punojmë së bashku për të luftuar terrorizmin nëpërmjet operacioneve të mbështetjes së paqes, për të promovuar sundimin e ligjit dhe për të trajtuar kërcënimet siç është siguria kibernetike. Kërcënimet globale kërkojnë përgjigje globale dhe partneriteti ynë me BE-në është thelbësor për këtë.

Së fundmi, BE-ja është një partner i domosdoshëm në mbrojtjen dhe avancimin e sistemit të tregtisë globale të bazuar në rregulla që është thelbësor për prosperitetin tonë të përbashkët - dhe atë të vendeve të vogla si Zelanda e Re. Ne gjithashtu përpiqemi së bashku për të siguruar që përfitimet e tregtisë të ndahen në mënyrë të drejtë midis të gjithë qytetarëve tanë.

Ruajtja e integritetit të Organizatës Botërore të Tregtisë natyrisht do të jetë në qendër të përpjekjeve të tilla. Por Zelanda e Re dhe BE-ja kanë një mundësi për t'i siguruar një impuls të mëtejshëm sistemit tonë global të tregtisë duke arritur një marrëveshje tregtie të lirë gjithëpërfshirëse dhe të cilësisë së lartë.

Pavarësisht nga lidhjet tona të ngushta dhe pikëpamjet e përbashkëta për tregtinë, ne aktualisht jemi diskriminues ndaj njëri-tjetrit për shkak të marrëveshjes së tregtisë së lirë me vendet e tjera. Një marrëveshje tregtie të lirë midis BE-së dhe Zelandës së Re do të sillte përfitime të konsiderueshme për të dyja palët. Më në përgjithësi, kjo do t'i jepte një nxitje shumë të nevojshme mbështetësve të tregtisë progresive, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme që sjell përfitime për të gjithë anëtarët e shoqërisë. Unë shpresoj që progresi drejt një marrëveshjeje të mund të bëhet sa më parë të jetë e mundur.

Zelanda e Re nuk i është shmanhur kurrë rolit të saj në skenën globale. Tani, ashtu si në kohët e mëparshme të paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë, ne qëndrojmë krah për krah me Europën në përbashkjen e sfidave më të mëdha globale. Distanca jonë fizike thjesht thekson thellësinë e këtij angazhimi.

* Autorja është kryeministres e Re. Marrë nga Project Syndicate.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës ka paralajmëruar masa reciprociteti në çdo fushë

Kadri Veseli: Taksa 100% ndaj Serbisë nuk do të hiqet

"Taksa 100 për qind ndaj Serbisë nuk do të hiqet. Madje, nëse Serbia do të vazhdojë me sjelljet agresive, ne do t'i shtojmë masat dhe do të kalojmë në reciprocitet të plotë me shtetin serb në çdo fushë. Taksa është vendosur në interes të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës. Partnerët tanë strategjikë dhe të përherëshëm, SHBA-të, nuk kanë kërkuar heqjen e taksës sepse ata nuk duan ta dëmtojnë dinjitetin e shtetit të Kosovës. Aleatët tanë kërkojnë që ne të dialogojmë për ta arritur marrëveshjen finale që është njohja e Kosovës nga Serbia dhe ulësja në OKB", ka thënë Veseli në televizionin "A2 CNN Albania". Kryeparlamentari kosovar ka folur për veprimet agresive të shtetit serb, që kanë çuar në vendimin e Kosovës për vendosjen e taksës 100 për qind. "Ne do t'ia bëjmë me dije çdo ditë Serbisë që pa e respektuar shtetin e Kosovës nuk mund të pres heqje të taksës. Do të vazhdojmë me reciprocitet të plotë. Ata i bllokojnë mallrat e Kosovës, ne i bllokojmë mallrat e Serbisë. Ata nuk na i njohin targarat e automjeteve, ne po



ashtu nuk do të njohim targarat serbe. Ata nuk i njohin vultat e shtetit të Kosovës, ne nuk i njohim tani vultat e Serbisë. Pra, do të shkojmë në reciprocitet të plotë dhe taksa 100 për qind do të mbetet varësisht si sillet Serbia", tha Veseli. Kreu i PDK-së i ka siguruar qytetarët e Kosovës se nuk do të ketë asnjë veprim që mund të dëmtojë raportet Kosovë-SHBA. "Unë i siguroj qytetarët e Republikës së Kosovës se nuk do të ketë asnjë veprim dhe asnjë lëvizje të shtetit të Kosovës që mund të dëmtojë raportet tona speciale me SHBA-të. Ne jemi në partneritet dhe koordinim të përhershëm. Krejt jeta ime politike është e ndërtuar në partneritet të ngushtë me SHBA-të, prandaj jemi vazhdimisht në koordinim me partnerët tanë strategjikë", tha Veseli.

Ambasadori i Rumanisë, vend që mban presidencën e BE-së, flet për "Diplomaticus"

Mircea Perpelea: Rumania e përkrah Shqipërinë për anëtarësimin në BE

Erion Kaçorri

Në fillim të vitit 2019, Rumania mori për herë të parë presidencën gjashtë mujore të Bashkimit Evropian. Në një intervistë për emisionin 'Diplomaticus' të gazetaris Erion Kaçorri që u transmetua në televizionin News 24, ambasadori i Rumanisë në Shqipëri, Z. Mircea Perpelea, foli mbi prioritetet e kësaj presidencie, që nga zgjerimi i familjes Europiane, hapja e negociatave me Shqipërinë, marrëdhëniet historike që Bukureshti ka me Tiranën dhe një sërë temash të tjera të cilat mund t'i lexoni si më poshtë.

Zoti Ambasador, duke nisur nga 1 janari, Rumania mori presidencën gjashtë mujore të Bashkimit Evropian. A do jetë zgjerimi me vendet e Ballkanit Perëndimor prioritet i presidencës Rumune?

Në këtë kontekst të gjerë, sigurisht që Rumania, krahas prioritetëve madhorë si emigracioni, Brexit, Buxheti Afatgjatë Evropian, prioritetet do të ketë dhe situatën në Ballkan dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian me vendet e Ballkanit. Ky është një subjekt kompleks. Rumania ka përuar gjithmonë që, të paktën për Shqipërinë ofron gjithë mbështetjen, por sigurisht dhe për vendet e tjera, por mund të them që me Shqipërinë, Rumania ka një numër të madh lidhjesh të vjetra dhe të qëndrueshme, kështu që mund të them se Shqipëria gëzon të gjithë mbështetjen e Rumanisë për këtë proces historik të antarësimit në Bashkimin Evropian.

Konkretisht cila do të ishte kështilla e Bukureshtit për një proces të suksesshëm të Shqipërisë në mënyrë që Tirana ta shfrytëzojë sa më mirë këtë moment duke qenë se Rumania ka qenë gjithmonë një vend aleat i Shqipërisë?

Ashtu është. Mund të themi gjëra shumë interesante për historinë e përbashkët dhe momentet e rëndësishme të historive të tyre të vendeve, por në lidhje me pyetjen tuaj rreth kështillave, të cilat mund t'i jepja unë ose vendi im është e vështirë për t'u thënë, sepse normalisht nuk ekziston një recetë, nuk ekziston një formë e caktuar e cila duhet ndjekur hap pas hapi. Në përgjithësi janë elemente madhorë, të cilët duhen marrë parasysh lidhur me zhvillimin ekonomik, lidhur me legjislativon, lidhur me korrupsionin, arsimimin, shëndetësinë, infrastrukturën. Ato janë pjesë e kapitujve të cilat Shqipëria dhe vendet e tjera të cilat duan të bëhen pjesë e Bashkimit Evropian duhet t'i përm-



Ambasadori i Rumanisë në Shqipëri, Z. Mircea Perpelea

bushin. Në qoftë se më pyesni mua personalisht, unë nuk mund të thosha gjë tjetër përveçse, pas dy vjetësh përvojë në Shqipëri, vendi juaj duhet të vazhdojë me të njëjtin ritëm, sepse që kur kam ardhur këtu, kam parë shumë gjëra pozitive dhe ndryshime për mirë. Ky ritëm duhet mbajtur dhe sigurisht duhet të kihet parasysh dhe përvoja e vendeve të tjera, ndoshta dhe e Rumanisë, sepse dhe ne kemi pasur një periudhë të ngjashme para antarësimit, kur na u desh të plotësonim kushtet e nevojshme. Ndoshta dhe tani duhet të vazhdojmë me disa rregullime, as tek ne nuk është gjithçka perfekte. Unë kam shkruajtur një libër, i cili u përkthye dhe në gjuhën shqipe dhe i cili shpreh disa këndvështrime, por dhe një evolucion ekonomik. Ky libër është trajtuar nga ana ekonomike dhe tregon rrjedhën e ngjarjeve, për të konkretizuar ecurinë tonë, gjë e cila mund të ketë jehonë pozitive dhe për Shqipërinë.

Zoti Ambasador, që pas antarësimit të Rumanisë dhe Bullgarisë në vitin 2007, procesi i zgjerimit ka qenë thuajse inekzistent duke përjashtuar Kroacinë në vitin 2013. Sipas jush, përse ka qenë kaq i ngadalshëm procesi i zgjerimit dhe a mendoni se ka një alternativë tjetër për vendet e Ballkanit përveç familjes europiane?

Sërisht do të fillojë me fundin e pyetjes tuaj. Jam i bindur se nuk ka tjetër alternativë për Ballkanin Perëndimor përveç atij të të qenit

pjesë e këtij klubi të vendeve të Bashkimit Evropian. Mund të shtoja faktin se Shqipëria, si i gjithë territori i Ballkanit Perëndimor është pjesë e Evropës. Pra, duke folur në mënyrë të logjikshme, Shqipëria është një vend Evropian. Problemet teknike të cilat shfaqen për t'u bërë realisht pjesë e Bashkimit Evropian, lidhen, ashtu siç po thosha, me përbushjen e disa kushteve të cilat Bashkimi Evropian, dëshiron që vendet, të cilat janë e pjesë e tij, t'i kenë të përbushura në një formë sa më të afërt me normalitetin. Ju them se as në Rumania nuk kemi mbaruar, ndoshta ishte një fillim i fundit dhe jo fundi i fillimit, në kuptimin që pas antarësimit gjërat vazhdojnë të zhvillohen, të harmonizohen. Ju më pyetët përse nuk pati momente të tjera që pas vitit 2007 kur Rumania dhe Bullgaria u antarësuan, më pas erdhi dhe Kroacia. Mund të them se kërkesat e Bashkimit Evropian, jo se janë shtuar, por në kuptimin e faktit se janë disa ndryshime të cilat duhen bërë. Domethënë, ashtu siç po thosha, është normale që vendet e Ballkanit Perëndimor të jenë pjesë e Evropës, por po aq normale është që ato ta ndajnë veten në Evropë, sepse vendi i shtetasve të tyre është në vendin e tyre, dhe në vendin e tyre, duhet të kenë kushte si në çdo vend të Evropës. Prandaj ka kaq shumë shqetësime, aq shumë ndryshime për të harmonizuar dhe barazuar kushtet e jetesës, ato ekonomike, politike, shoqërore, kulturore dhe të gjitha të tjerat që na

referohen në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Ju keni shkruar edhe një libër mbi ndryshimet që ka përjetuar Rumania. Sa ka përfituar vendi juaj nga antarësimi në strukturat europiane?

Në radhë të parë unë do t'i shmangësia fjalës përfitim. Është një term ekonomik. Të përfytyrosh do të thotë të fitosh në një mënyrë ose në një tjetër në një formë të themi ekonomike.

Le të flasim për përfitimin ekonomik.

Në qoftë se flasim ekonomikisht, shifrat janë të paktën interesante. Për shembull Rumania ka tërhequr shumë fonde nga Evropa, deri tani janë tërhequr rreth 35 miliardë euro. Prodhim i Brendshëm Bruto është rritur me të paktën 100%. Në qoftë se në vitet '90 kjo shifër ishte 100 miliardë tani ka arritur në 200 miliardë euro dhe jemi ndër 6-7 vendet e para në Evropë nga fuqia ekonomike. Shifrat janë shumë interesante, jo gjithmonë reflektohen, domethënë zhvillimi dhe dinamika e shifrave jo gjithmonë zhvillohen në evidencim e nivelit të jetesës, por me siguri Rumania është diçka tjetër, duket ndryshe për gjeneratën e re, por dhe për ne që kemi kaluar dhe etapë të tjera, por më e rëndësishmja është që duke u bërë pjesë të ky klub i vendeve evropiane, kemi sigurinë që Rumania mund të aspirojë jo vetëm në një vend në Evropë, por dhe në një situatë dhe në një mënyrë jetese të njëjtë me çdo vend tjetër të Evropës.

Zoti Ambasador, duke

qëndruar të raportet mes dy vendeve tona, Rumania ka qenë vendi i parë që ka njohur pavarësinë e Shqipërisë. Pse pikërisht Bukureshti?

Pyetja është interesante, por edhe përgjigja është interesante, sidomos që Shqipëria nuk është një vend kufitar me Rumaninë. Besoj se ka përgjigje të sakta, mund të niseshim nga historia, mund të niseshim nga periudha e arsimimit francez të cilin intelektualët shqiptarë dhe rumunë e morën në Francë në shekullin e XIX-të, mund të mendojmë më tej te familja e shquar Gjika e cila në Rumania përfaqëson një pike orientimi nga të gjitha këndvështrimet. Përse jo, lidhjeve më të vonshme të miqësisë midis njerëzve të rëndësishëm, intelektualë të Rumanisë dhe Shqipërisë, të mos harrojmë dhe nuk ka si të neglizhohet fakti që Rilindja shqiptare nisi në Bukuresht, që himni u krijua në Bukuresht, që buxheti i parë i Shtetit shqiptar ishte dhuratë e Rumanisë, që mbështetja fundamentale pas Luftës së Parë Botërore, ishte e konsiderueshme dhe ka më shumë momente. Pra të gjitha këto i dhanë kontur një lidhje të vjetër dhe të qëndrueshme, e cila disa here është më e rëndësishme se shifrat. Lidhja historike, emocionale, gjuhësore është shumë më e qëndrueshme, dhe do të shtojta diçka. Në të gjithë këtë lidhje nuk duhet të harrojmë në asnjë moment minoritetin arumun të pranishëm në Shqipëri, i cili është një faktor i vazhdueshëm lidhjeve në të tashmen dhe në të shkuarën midis dy vendeve dhe i cili bën që në vazhdim të kemi bashkërisht vlera të cilat i respektojmë në mënyrë të ndërsjellë.

Zoti Ambasador, si janë raportet sot mes dy vendeve tona si nga aspekti politik ashtu edhe ekonomik?

Në radhë të parë mund të them se ato janë në një dinamikë rritje, domethënë shifrat janë në rritje. Nuk mund të them se sasia, ose në qoftë se dëshironi madhësinë e shifrave janë shumë interesante. Vitin e kaluar patëm një marrëdhënie ekonomike të pozicionuar në shifrën 120 milionë euro. Sigurisht që Rumania ek-

sporton më shumë sesa importon. 75% e asaj shifre e përfaqësojnë eksportet shqiptare në Rumania. Ideja është që disponibilitetet janë të mëdha. Kemi këtë mision të rritjes së marrëdhënieve ekonomike midis dy shteteve. Nuk mund të thosha se janë parësore por janë të rëndësishme. Kohët e fundit u bë një forum ekonomik rumunoshqiptar, në muajin nëntor. Morën pjesë një numër i madh biznesmenësh nga Rumania, te shpresojmë se do të ketë momente të tjera, një reciprocitet, me biznesmenë shqiptarë të cilët të shkojnë në Rumania. Ndoshta qeveria shqiptare do të marrë në konsideratë lehtësira për investitorët në përgjithësi, por dhe për këmbimet midis Rumanisë dhe Shqipërisë në veçanti. Pra jam optimist, edhe pse personalisht, nuk jam plotësisht i kënaqur, sepse potenciali është shumë më i madh, ndërsa ne, do të mundohemi të bëjmë çfarë të mundemi për të rritur këto shifra të lidhura me aspektin ekonomik.

Çfarë mund të themi për marrëdhëniet mes dy popujve tanë? Kam informacion se shumë të rinj shqiptarë kanë studiuar në universitetet rumune?

Rumania ka pasur përveç prioritetëve të lidhura me marrëdhëniet e veçanta me Shqipërinë dhe dhënien e bursave të studimit. Mund të them se Rumania, çdo vit, të paktën nga viti 1992 jep një numër të rëndësishëm bursash, rreth 100, sipas kërkesave, pra rreth 100 studentë shqiptarë, kryesisht arumunë vijnë për të studiuar në Rumania dhe në këtë mënyrë bëhen dhe ata një urë lidhëse e miqësisë të cilën kemi dhe e respektojmë, sepse një pjesë të madhe e gjëjmë në pozicione të rëndësishme, zyrtare, në aktivitetet specifike dhe me të cilët mund të punojmë bashkërisht në zhvillimin e marrëdhënieve tona. Është kënaqësi për mua si profesor universitar të konstatoj se Rumania është një vend tërheqës, e vërtetë që për disa specializime si mjekësia dhe inxhinieritë, por kam takuar shumë intelektualë në Shqipëri, shqiptarë që janë krenarë dhe jo vetëm krenarë, por dhe të lumtur që kanë studiuar në Rumania. Pra, kjo mënyrë për të rritur marrëdhëniet e veçanta, specifike midis dy vendeve është e dobishme për të dyja palët.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID


BalkanWeb.com
BW

FALAS



INTERVISTA

Flet aktorja që interpreton 'Letër fëmijës që nuk lindi kurrë'



Fatmira Nikolli

INA GJONCI:

Mes tiranisë së shtatzënisë,
të drejtës dhe detyrës

mbi trupin e saj, por sa i flet ai tekst shoqërisë donë. Sot, kur ne vijojmë të jemi po aq e pasigurtë dhe "ligësia vazhdon të qëndrojë si bishë, gati për të të shqyr", dilema mbi ekzistencën vazhdon të jetë e njëjtë. Pjesa ringjitet në skenë me datat 24, 25, 26 dhe 27 janar në sallën "Gëte"

Çfarë të bëri të zgjidhje "Letër fëmijës që nuk lindi kurrë"? Kur e ke njohur veprën dhe sa kohë ke punuar me të?

Po bëhem si Lady Gaga tek intervistat për "A star is born". I kanë bërë një përmbledhje të deklaratave e ka thënë 247 herë të njëjtën gjë. Po mendoj çfarë të të them ndryshe. Po ja që, me ngacmon ideja që lindja shihet si një akt i përgjegjshëm, e që një grua që zgjedh punën para memësisë, e jetën e vet para një jete të re të pafomuar ende, në këtë tekst artikulohej qartë. Veprën e kam njohur që adoleshente në gjuhën italiane, kam punuar me prof. Alfred Trebickën për ta paraqitur në konkurs e kështu që m'u desh ca më pak kohë ta përshtatja e ta përktheja pjesën e përshtatur, pasi e dija fillin logjik të veprës.

Kur po punojte me tekstin, a kishe ndërmend një grua të caktuar tek e cila do e mbështetje personazhin tënd?

Çdo grua është "Ajo". Me dilemat e pikëpyetjeve të saj. Fillimisht, duke e njohur mirë Fallacin, cinizmin e saj, ftohtësinë e saj, mendova të ishin elemente që mund t'ia jepja personazhit. Pak më vonë-pasi puna është gjithnjë një proces- mendova të kundërtën. Arsyeja ishte e thjeshtë: mendohje se historia e saj ishte një autobiografi: Fallaci ka humbur një fëmijë me dashurinë e jetës, Panagulisin. Së fundmi u gjet dorëshkrimi origjinal e datat nuk konvergjonin. Pra, Fallaci ka patur ndeshmëri e gjenialitet, të kuptojë botën e një gruaje që pret fëmijë pa qenë vetë shtatzënë. Kështu që mendova të bëj të njëjtën gjë: të jem unë në rrethanat e personazhit.

Teksti ofron çaste shprese, por edhe çaste dobësie, zhgënjimi, dorëzimi. Si ishte të vishje lëkurën e asaj gruaje që dëshiron të sjellë një jetë një fëmijë përkundër gjithë vështirësive me të cilat përballlet?

Siç po thosha dhe më lart, vendosa të vë veten në rrethanat e caktuara. Ardhja e një fëmije është një moment që të përmbys-sigurisht për mirë- jetën, por ngre dilema e pikëpyetjeve. Me shumë se shtatzënia, unë doja që shfaqja të ishte një "tribut" një homazh për jetën. Një pamflet për botën e për vështirësitë e të jetuarit në të. Vetë jam natyrë, ca "ekzistencialiste", ndaj kjo më



Ina Gjonci

ndihmoi.

Përfshihen në të, edhe çështje të lëvizjeve a ideve feministe: mbi të drejtën e një gruaje të vendosë për fëmijën e saj dhe trupin e saj. Cili është qëndrimi juaj për këtë?

Eh. Kjo ishte pjesa që paraqiste po ashtu interes për mua. E kam provuar në "Tramvaji Dëshirë", etjen e grave për të parë një grua në skenë që përballlet me thashethemet, paragjykimet e për të cituar Fallacin "një botë të ngritur nga burrat për burrat". Gra pa fund më shkruanin atëherë e gra pa fund më shkruajnë edhe sot. Memësia nuk është detyrim. Është e drejtë. Që përdoret ose jo. E askush nuk mund të gjykohej për të kundërtën. Meshkujve atësia u shërbehet si një pjatë supe e ngrohtë, ndërsa femrat kanë ca "logari" më shumë për të bërë.

Dhe si ia dole të tejkalojë atë që ti mendon për këtë teksta ishte në rol?

Ishte dhe jam me mendimin kategorik të Fallacit që lindja është një "akt i përgjegjshëm". As një "fakt biologjik" jo. Një fëmijë nuk sillt në jetë "për vete dhe kaq". Fallaci, i përshkruan botën një genjeje duke i dhënë një mundësi sublimë: të zgjedhë vetë, nëse do, apo jo, të ngjitet në skenën që qu-

het jetë.

Si ishte të mbaje vetëm në skenë publikum të mbërthyer, në një skenë ku spektatori duket aq afër sa të jetë pjesë e skenografisë?

Unë kisha frikë e nuk druham ta pranoj. Ishte hera e parë për mua në një monodramë. Por nuk jam vetëm. Kam "fëmijën". E ai është një partner shumë i mirë.

Megjithëse e shkruar më 1975, një grua e pamartuar, në karrierë që pret një fëmijë babai i të cilit nuk "është", në Shqipëri është ende një realitet disi i huaj. Sa i takon anës morale, si u prit?

Unë kisha një tjetër pasiguri. Nuk dija se si do ta prisnin mamatë e martuara, lumturisht të martuara që kanë sjellë në jetë fëmijë pa dyshime e pikëpyetje. Shoqe të mia nëna të reja më vërtetuan të kundërtën: edhe ato e kishin gjetur veten tek dilemat e personazhit e nuk kishin asnjë paragjykim për këtë grua e cila merr valixhen e zgjedh vetveten. Ndonëse që u rezultoi fatale për jetën që po vjen...

Apo u prit me distancën e një veprë të huaj, ku ngjarjet ndodhin larg nesh?

Personazhi, thotë Fallaci, është një grua pa fytyrë, pa emër, pa prejardhje. Teksti nuk ka referen-

ca italiane. Unë nuk i dhashë referenca shqiptare. Kjo grua nuk mund të jetë e largët. Kjo grua është secila nga ne, kudo nëpër botë.

Sa mendon se ka vend në shoqërinë tonë një grua e tillë- apo te ne një fëmijë i tillë abortohet ende në heshtje?

Ka shumë vend pasi e para kjo grua nuk aborton. Ka një abort spontan, sepse zgjedh mos i nënshtrohet tiranisë së shtatzënisë, zgjedh të punojë, të jetojë jo si "gyp apo kontenier". Fakti që salla është e mbushur, me thotë që ka vend e ka vend mjaft, për të folur për gruan në këtë vend ku problemet e saj artikulohej kaq pak. Ku "të mos jesh nënë" shihesh si një fatkeqe që nuk po lë asgjë nga pas, e asnjëherë si një zgjedhje e jotja, e përgjegjshme. E ku shpesh fëmijët përdoren dhe si kupa triumfi në një marrëdhënie dashurore. Një për botë po flitet shumë për këtë. Tek ne shumë pak. Është e tejkaluar tashmë. Mbrëmë po flisja me një mikeshë e cila më tha "kur them se nuk dua të kem fëmijë, njerëzit nxjerrin harqet, shigjetat dhe shurkat".

Ti nuk je një jetë, ti je një mundësi jete", i thotë gruaja fëmijës së vet. A nuk jemi pak a shumë të gjithë kështu; një mundësi jete pa arritur të jemi vërtetë jetë?

Patjetër. Pse jo? Nuk e kisha e menduar. Edhe pasi vijmë në jetë, vazhdon e njëjta histori. Çdo ditë është një betejë për të qenë apo për të mos qenë.

A është sjellja në jetë e një fëmijë detyrë apo e drejtë morale?

Është zgjedhje e përgjegjshme. Është e drejtë morale. E nuk ka se si të jetë detyrë. Lindjen e një fëmije e kam imagjinuar gjithmonë mbi të gjitha si një akt të natyrshtë dashurie. Edhe kjo, sipas autores do ishte ca egoizëm. Ti do dikë, e zgjedh, po për veten tënde të krijosh një lidhje akoma më të fortë me njeriun që do e vjen fëmija. Sapo martohesh të pyesin "kur bebi?" E kur ky vjen të thonë "kur tjetri?" Por Fallaci donte të ndryshonte botën besoj...

E megjithatë një fëmijë e ndryshon tërësisht një grua; jetën e saj, mundësitë e saj dhe pamundësitë e saj, apo jo?

Do pyes shoqen time Edin e cila sapo është bërë mami i një goce të bukur hahaha. Bëj shaka, sepse mendoj që po. Në të kundërtën askush nuk do kishe pikëpyetje. Depresionet pas lindjes, nervat, problemet mes partnerëve, pas ardhjes në jetë të një fëmije, janë gjithnjë fryt i mos artikullimit të problematikave që Fallaci ngre, para shtatzënisë.

"Twitter" kundër demokracisë? Orwelli dhe rreziku tiranik i medias sociale

"The Week"

(vijon nga faqja 1)

.. shumë më tepër.

Së pari, të enjten mbrëma, "Buzzfeed" botoi një skrup sensacional, ku hidheshin dyshime se Presidenti Trump korruptoi dëshminë e rreme të ish-avokatit të tij, Michael Cohen. Siç raportuan shumë media me reputacion dhe personalitete mediatike në "Twitter" gjatë ditës pasardhëse, nëse ishte i vërtetë, ky ishte një akt shumë i rëndë. Karakteri i paverifikuar i akuzës nuk bëri asgjë për të penguar një sërë komentatorësh që të sugjerorin se presidenti ishte tashmë në prag të 'impeachment'-it dhe largimit nga detyra. Megjithatë, të premtën mbrëma, lajmi pësoi një goditje të fortë kur Këshilltari Special, Robert Mueller, nxori një deklaratë nëpërmjet zyrës së tij, ku vihej në diskutim saktësia e akuzës.

Më pas, të shtunën, u shfaq në "Twitter" një video, në të cilën dallohej një grup nxënësish të shkollës së mesme që përplaseshin dhe tallnin një protestues me origjinë nga indianët e Amerikës, njëkohësisht veteran i luftës në Vietnam. Deri të shtunën herët pasditë, kjo video kishte shkakuar spazma të forta denoncoimesh në "Twitter" - për adoleshentët racistë, për shkollën e tyre katolike fanatike në Kentucky, për lëvizjen e mbushur me urrejtje të Pro-Jetës, dhe në fakt për këdo që mban një kapele MAGA në publik.

Adoleshenti kryesor që shfaqej në video u trajtua si simboli i supremacisë së bardhë dhe buzëqeshja e tij (apo ngërdheshja) tek përballje me kundërprotestuesin, u ilustrua si provë që ai është pasardhës i drejtpërdrejtë i fanatikëve, që dikur u ngritën kundër Lëvizjes për të Drejtat Civile. Edhe pasi u shfaqën video më të gjata dhe më të plota të përplasjes, ku dukej qartë se ngjarjet ishin shumë më pak të rënda nga sa ishte raportuar fillimisht, turma e "Twitter"-it vazhdoi që të sulmojë nxënësit, duke thënë se fytyrat e tyre meritonin një grusht të fortë.

Asnjë prej këtyre dy ngjarjeve nuk është shumë e rëndësishme në skemën e madhe të gjërave. E para ose do të vërtetohet, ose do të groposet nga raporti që Muelleri do të nxjerrë, në lidhje me bashkëpunimin të mundshëm të fushatës së Trumpit dhe qeverisë ruse, në zgjedhjet e vitit 2016. E dyta do të humbasë dhe harrohet nën një mal shpërthimesh të reja zemërimi, që do të vazhdojë të tronditë vendin, gjatë epokës Trump dhe përtej saj.

Megjithatë, të dyja janë treguese të dëgjave ogurzezë që po ndodh në kulturën tonë politike. Polarizimi ekstrem partiak është duke u kombinuar me



teknologjinë dhe mediat sociale, e sidomos "Twitter"-in, për të provokuar një formë çmendurie të përsëritur politike, mes anëtarëve të elitës kulturore dhe intelektuale të vendit. Dhe kjo çmenduri, kur kombinohet me ekstremizmin në rritje të së djathtës populiste, po e shtyn vendin drejt disa formave të rrezikshme joliberalë të politikës.

Kultivimi dhe ruajtja e politikës liberale, në një shtet me përmasa kontinentale dhe me më shumë se 300 milionë banorë është gjë e vështirë. Kjo bëhet veçanërisht e vërtetë, kur polarizimi ideologjik dhe zhvillimet teknologjike inkurajojnë tendenca politike dhe kulturore, që e vështirësojnë edhe më shumë. Të dyja këto gjëra ndihmuan për të sjellë Donald Trump

në Shtëpinë e Bardhë. Por ato na kanë dhënë gjithashtu një reagim joliberal ndaj presidencës së tij, nga ana e aktivistëve progresistë, gazetarëve dhe personaliteteve të tjera mediatike.

Shumë është thënë për mënyrën se si "Twitter"-i shërben si një megafon për zemërimin popullor, gjë që është forcur më shumë prej shpejtësisë së ciklit të lajmeve dhe ligësisë së spikatur si dhe absurditetit të Shtëpisë së Bardhë të Trumpit. Por shumë pak vëmendje i është kushtuar atij që mund të jetë aspekti më i fuqishëm i platformës së medias sociale: aftësisë së saj për të ushqyer vanitetin e përdoruesve. Ka gjithmonë një element egoizmi në debatin intelektual dhe politik. Por "Twitter"-i vendos çdo përdorues në një skenë

masive, me sharjet, fyerjet dhe provokimet më të ndyra, që zakonisht marrin më shumë duartrokitje. Dhe ky është një stimul shumë i madh politik për të përshkallëzuar denoncimin e armiqve politikë. Sa më shumë që shprehet zemërimi ndaj të këqijave që bëjnë të tjerët, aq më shumë shijohet miklimi i turmës virtuale.

Po a nuk është një turmë virtuale, shumë më pak e dëmshme se një turmë reale? Unë vetë e kam sugjeruar këtë gjë në një shkrim të kohëve të fundit, me titull: "Nëse mendoni që një luftë civile është pranë, largohuni nga 'Twitter'-i". E megjithatë, gjithmonë e më shumë helm është derdhur në botën reale, me bojkote, dëbime, kërcënime me vdekje dhe apologji puthadoraze për të zbutur sferat digjitale të turmës. Gjithnjë e më shumë duket se është çështje kohe, përpara se dhuna e botës reale të shpërthejë, si pasojë e një acarimi 'online'.

Por, ky nuk është rreziku i vetëm që "Twitter"-i paraqet për jetën tonë civile. Siç shkruante Andrew Sullivan tri vite më parë, në një ese mbi rrëshqitjen e Amerikës drejt tiranisë, Platoni besonte që regjimet politike dhe

shpirtrat e qytetarëve janë pasqyra të njëri-tjetrit. Një ndryshim në formën politike mund të shkaktojë ndryshim në karakterin e qytetarëve dhe e anasjella. Tiranitë shfaqen në shumë mënyra, por ndonjëherë ato ngrihen kur qytetarët e një komuniteti politik demokratik zhvillojnë frymë tiranike.

Ajo që na shfaq "Twitter"-i është një radiografi në kohë reale i shpirtit të elitës intelektuale dhe kulturore të Amerikës dhe aktivistëve të saj më të përkushtuar - njerëzit që kanë detyrë të shpërndajnë dijen dhe që marrin udhëheqjen, në organizimin e veprimit politik në shoqërinë tonë. Panorama që zbulon është e shëmtuar, vulgare, e frikshme dhe jotolerante, me shpirta që nxjerrin zbuluar paafësinë e tyre për të përtypur, peshuar provat dhe gjykat me objektivitet. Ata shfaqin një impulsivitet dhe zemërim ndaj armiqve politikë, që janë të papajteshme me mendimin e arsyeshëm, mbi mënyrën si duhet të qeverisemi, shërojmë ndarjet dhe shmangim kolapsin në dhunë civile, që mund të shpjerë më tej në tirani.

Tek "1984", George Orwelli përshkruante një rend politik totalitar, ku njerëzit mbaheshin si qengja të urtë, përmes një rituali të përditshëm që quhej "Urrejtja 2-Minutëshe", gjatë të cilit popullsia drejton gjithë zemërimin e vet tek "Goldstein", një armik i sajuar i shtetit.

Falë "Twitter"-it, tani e dimë që e njëjta dinamikë mund të shfaqet spontanisht, me zemërimin që orientohet nga manifestimet e reja të armikut partiak, pothuajë përditë. Kjo na tregon se në rrethana të caktuara - rrethanat tona - njerëzit mund të kapen dhe do të kapen pas një njëpasnjëshmërie Goldstein-esh të jetës reale, thjesht për ta shijuar - për kënaqësinë e pastër të denoncimit të manifestimeve të ligësisë në mesin tonë. Me sa duket, asgjë nuk kënaq më shumë se sa denoncimi i bashkatdhetarëve tanë për dështimet e tyre morale dhe të zhyturit në kënaqësinë e fantazive të ndëshkimit të tyre.

E shohim këtë në të djathtë, e shohim në të majtë dhe e shohim gjithnjë e më shumë edhe mes gazetarëve jopartiakë. Pavarësisht se ku e ka origjinën në spektrin politik, është një impuls që e ushqemë, për të keqen tonë.

Edhe sa kohë, qytetarët e konsumuar prej dëshirës së pangjishme për të ndaluar dhe degdisur kundërshtarët ideologjikë në honet më të thella, do të vazhdojnë të shohin ndarjen dhe këmbimin e qeverisjes, si një zakon dhe ritual qytetar me vlerë? Mund t'i jemi afruar rrezikshëm zbulimit të kësaj.

Bota.al

Po a nuk është një turmë virtuale, shumë më pak e dëmshme se një turmë reale?

Unë vetë e kam sugjeruar këtë gjë në një shkrim të kohëve të fundit, me titull: "Nëse mendoni që një luftë civile është pranë, largohuni nga 'Twitter'-i".

Opinion i Ditës

Miti që po thyhet në universitete

Nga Andi Bushati

(vijon nga faqja 1)

... Sepse për herë të parë me qindra punonjës që paguhen nga buxheti i shtetit, jeta e të cilëve në një mënyrë apo në një tjetër varet nga zyrtarët e kontrolluar nga qeveria, nga lakejtë e pushtetit, nga shefat e vendosur politikisht, kanë marrë guximin të dalin hapur dhe të sfidojnë në mënyrën më dinjitoze të mundshme një qeveri shurdhe dhe autoritare. Ata po thyejnë përditë e më shumë mitin rrogëtarit kokulur, servil dhe që shikon punën e tij, të instaluar prej vitesh.

Fjala është për ata pedagogë që prej fillimit të këtij janari, jo vetëm u janë bashkuar kërkesave të studentëve, por kanë shkuar edhe më larg. I kanë kërkuar qeverisë "Rama" heqjen e vargonjëve të pushtetit të parasë dhe autonomisë së cunuar që prodhon Ligji i shumë debatuar i Arsimit të Lartë.

Dhe e kanë bërë këtë në mënyrën më fisnike të mundshme: duke iu kundërvënë rektorëve dhe dekanëve të politizuar, që vazhdonin me thirrje për të rifilluar mësimin, duke mbledhur forumet më demokratike të mundshme, asambletë e fakulteteve, ku për vendimet e mara janë shprehur me votën e tyre të lirë të tërë pedagogët.

Për të gjithë ata që nuk e kanë ndjekur hap pas hapi, kronika është e thjeshtë.

Në 15 janar gjithçka filloi në Fakultetin e Shkencave Sociale, ku 75 pedagogët votuan për përkrahjen e kërkesave të studentëve, rrëzimin e reformës në arsim, tërheqjen e VKM-ve të qeverisë "Rama" të dala nën urgjencë dhe ankth, në fund të dhjetorit.

Ata nuk u mjaftuan me kaq. Në sallat e leksioneve që i shndërruan në aula debati, diskutimi apo projektimi dokumentarësh, ku mësimdhënës dhe mësimnxënës diskutonin së bashku, jo vetëm si bëhej më i mirë universiteti, por edhe krejt shoqëria, ata u drejtuan thirrje edhe fakulteteve të tjera



për solidarizim.

Të hënën e kësaj jave, në një formë pak më të ndryshme, eksperiencën e përsëritën pedagogët e filologjikut. Ata organizuan një grevë njëditore që mbështetej tek po të njëjtat kërkesa.

Historia vazhdoi me votimin e asamblesë të të gjithë trupës mësimore të Gjeologji-Minierave dhe tani së fundi me atë të Shkencave të Natyrës.

Thelbi i gjithë këtyre lëvizjeve është solidariteti me studentët, rrëzimi i Ligjit për Arsimin e Lartë për të cilin kryeministri ka qenë kategorik, se nuk ndryshon, si dhe tërheqja e VKM-ve të qeverisë që në vend ta çlirojnë e ndrydhin edhe më shumë autonominë universitare.

Por mbi të gjitha ato kanë rëndësi për diçka tjetër.

Pavarësisht se u ngjizën si reagim ndaj dhunës policore që u ushtrua ndaj studentëve këtë fillim viti, pavarësisht se u mbarsën nga përpjekja maoiste e Edi Ramës për t'u rreshtuar në krah të "ngelsave", për të linçuar mësimdhënësit e tyre, pavarësisht se u frymëzuan nga arroganca e një qeverie që jo vetëm nuk dëgjon, por edhe urdhëron duke nxjerrë fermane, ato kanë një peshë historike.

Sepse ato do të mbahen mend si filizat e para, si aktet kurajoze që po tentojnë t'i japin fund dorëzimit të pjesës më të iluminuar të shoqërisë përpara pushtetit, indiferencës për të reaguar ndaj të fuqish-

mëve që marrin vendime në emër të të gjithëve, frikës së përbaljes me ata që kanë në dorë shumë më tepër sesa pagat mujore.

Prandaj, ajo që po ndodh në universitetet kryesore të vendit, ku nën shembullin më të mirë të studentëve të tyre edhe pedagogët janë vetë organizuar, kanë mbledhur asambletë, kanë ushtruar demokracinë, duke votuar lirisht, është një ngjarje që duhet mbajtur shënim.

Pikërisht, në momentin kur shumëkush ka në majtë të gjuhës togfjalëshat: "në këtë vend nuk ndodh më asgjë", "këtu ka vdekur çdo fibër dinjiteti dhe rezistence" me qindra pedagogë, për nderin e tyre, po dëshmojnë të kundërtën. Ata janë sot shembulli më i mirë i kësaj shoqërie.

HOROSKOPI

DASHI

Sot veprimet tuaja do të ndihmojnë të vendosni bazat për diçka që do t'ju bëjë të dalloheni nga njerëzit që admironi më shumë, prandaj veproni me mend dhe gjithmonë merri rrugën kryesore. Një ndryshim i vërtetë do të vijë në jetën tuaj.

DEMI

Ju keni shumë ndikim mbi të tjerët, dhe nuk ka asgjë të keqe për ta përdorur atë që të lehtësoni rrugën tuaj ose për të krijuar një ndjenjë më të fortë harmonie mes të gjithëve. Ka diçka në fëmijë me personalitetin tuaj që inkurajon njerëzit dhe frymëzojnë besnikërinë.

BINJAKET

Kjo ditë mund të shërbejë si bazë e përkryer për një ide apo përpjekje të re, ndaj përpunoni të përfortni nga kjo! Vendosni një projekt apo qëllim të rëndësishëm në krye të listës tuaj të detyrave, dhe nëse nuk mund të bëni përparim të madh, të paktën filloni.

GAFORJA

Dita e sotme ju ofron një dozë të mirë energjie pozitive dhe një dhuratë bujare shprese. Njerëzit në jetën tuaj kanë shumë energji ngjitesë, kështu që bëni një përpjekje për të hyrë në veprime. Diçka e re është duke shpërthyer në jetën tuaj.

LUANI

Ashtu si një fener gjatë një nate të stuhishme, ju mund të shërbeni për shpëtimin e jetës së disa njerëzve të rëndësishëm sot. Ju po shndërroheni në një bashkëpunëtor shumë të vlefshëm. Njerëzit janë duke u mbështetur në aftësinë tuaj.

VIRGJERESHA

Sot është e rëndësishme që ju të mësoni se si të respektoni zgjedhjet që bëjnë njerëzit e tjerë. Trajtoni të tjerët siç do të donit të trajtoheshit edhe ju. Nëse ka çështje specifike me të cilat doni të merreni, do të keni shumë energji për të bërë diçka.

PESHORJA

Nëse jeni duke pritur për një ngjarje të rëndësishme për të situat dramë ose intrigë në jetën tuaj, atëherë do t'ju duhet të prisni për një kohë të gjatë. Nëse ju jeni i mërzitur sot, mos rini në një vend. Shikoni jetën tuaj nga një perspektivë e reaksuar.

AKREPI

Sot do të jetë koha e përsosur për vlerësimin e gjërave në jetën tuaj që nuk ju bëjnë shumë të lumtur. Herët a vonë, gjërat do të vendosen në vend dhe gjithçka do të bëhet shumë më e qartë.

SHIGJETARI

Jeni në gjysmën e një procesi të madh vendimmarrës. Gëzojuni këtij fakti dhe kini besim në faktin se përfundimisht do të arrini një përfundim të rëndësishëm. Nëse jeni në një marrëdhënie, gjërat do të rëndojnë pak.

BRICJAPI

Ndonjëherë ju mund të përfshihen në emocione dhe në sfidat e jetës tuaj saqë harroni disa momente të rëndësishme. Kaloni më shumë kohë me njerëz që sjellin gëzim në jetën tuaj.

UJORI

Kthejeni të gjithë vëmendjen tuaj drejt zgjidhjes së disa çështjeve të papërfunduara sot. Kjo mund të sjellë disa lëvizje të mëdha. Mos u trembni, por bëni sa më shumë telefonata për t'u lidhur me njerëzit.

PESHQIT

Gjërat po fillojnë të lëvizin në një zonë të jetës suaj që rrallë, ose asnjëherë nuk i kushtoni vëmendje. Në dashuri keni nevojë për një impuls të ri që do të sillte shumë ngjyrë në jetën tuaj.

KUPA E SHQIPËRISË

Tirana arrin një fitore të pastër ndaj Flamurtarit, teksa në "Selman Stërmasi" bardheblutë kanë thyer vlonjatët me shifrat 2-0 në sfidën e vlefshme për Kupën e Shqipërisë. Një ndeshje që ka zgjatur 24 orë, pasi sfida ishte në program të mërkurën në orën 17:00, por reshjet e dendura bënë që zyr-



Tirana gjunjëzon Flamurtarin, çerekfinalelet më pranë

tarët e FSHF-së ta zhvendosin për të enjten në orën 13:00. Kryeqytetasit humbën një penallti në minutën e 11-të, kur portieri Koliçi me këmbë neutralizoi goditjen e Hasanit. Gjithsesi, bardheblutë do të këmbëngulin dhe në të

37-ën do të gjejnë epërsinë me shtatlartin Ngo, që shfrytëzoi mjaft mirë hutimin e mbrojtjes mike. 3 minuta më pas është Hoxhallari që dyfishon, teksa goditja e tij nga distanca përfundon në rrjetë dhe falë bashkëpunimit të port-

ierit Koliçi. Pjesa e dytë është gjithashtu e luftuar, me vlonjatët që nervozohen edhe me vendimet e kryesorit Bajramaj (minuta e 85-të), ndërsa Tirana pretendon një tjetër penallti (84), por pavarësisht antagonizmit, sfida do të përfundojë 2-0 dhe Tirana shkon në Vlorë me një rezultat mjaft të favorshëm për të synuar kalimin e turit.

KRYENDESHJA



Andi Koçi, gjyqtari i Skënderbeu-Partizani

Kampionati rinis nesër me ndeshjen Skënderbeu-Partizani, më e rëndësishmja për javën e 19-të të Superiores. Korçarët kërkojnë kthesën në kampionat, ndërsa të kuqtë duan të ruajnë diferencën me vendin e dytë. Për këtë ndeshje, "Vipsport.al" mëson se është caktuar të gjykojë Andi Koçi, arbitri nga Durrësi, ndërsa ndihmës të tij do të jenë Ermal Barushi dhe Fatmir Lamaj. Kampionati hyn gradualisht në një fazë interesante dhe gjykimi ka një rëndësi edhe më të madhe, sidomos në ndeshjet e rivalëve direkt, siç është edhe sfida e nesërme në Korçë. Bie në sy fakti që për këtë ndeshje FSHF-ja nuk ka zgjedhur asnjë nga tre arbitrat me stemën e FIFA-s. Stadiumi i Korçës është një nga stadiumet ku arbitrohet në mënyrë komode dhe pritët që arbitrat nesër të jenë në lartësinë e duhur.



Jeton Selimi

"Vij nga familje e varfër", mbrojtja e sportistes nuk prek krerët e federatës ndërkombëtare

Peshëngritje, Romela Begaj përjashtohet 8 vite

Për shtangisten 33-vjeçare, karriera konsiderohet e mbyllur

Ajo që pritej prej më shumë se një viti ka marrë formë zyrtare. Kishte shumë pak dyshime, por tani edhe ato janë shuar me dopingun që kthen në plagën më të madhe të peshëngritjes shqiptare. Federata Botërore e Peshëngritjes ka dënuar me 8 vjet përjashtim Romela Begaj, pasi peshëngritja nuk arriti të mbrohet përpara gjykatësve, pasi rezultoi pozitive në testet antidoping gjatë Botërorit të vitit 2017. "Balkanweb" siguron vendimin e dërguar në korrespondencën zyrtare të Federatës Botërore me atë shqiptare të peshëngritjes. Përgjigjet e testeve u bënë të njohura fillim të vitit 2018, ndërsa në atë kohë Romela Begaj mhoi dhe u betua se nuk kishte përdorur stanazonol, substancë dopuese e gjetur në teste. Edhe mbrojtja e sportistes shqiptare nuk ka bindur panelin e gjykatësve. "Vij nga një familje e varfër dhe kam kaluar shumë vështirësi në fëmijëri dhe adoleshencë. Peshëngritja është i vetmi burim i të ardhurave dhe nuk do bënte asgjë për të dëmtuar karrierën", lexohet në dokumentin zyrtar të siguruar nga "News 24". Por



më shumë se kaq, në vendimin e Federatës Botërore të Peshëngritjes ka rënduar precedent i vitit 2004, ku Romela Begaj rezultoi poziti-

ve me të njëjtën substancë, stanazonol. Për këtë, Romela Begaj u mbështet fortë në teorinë konspirative se ishte sabotuar, por kjo nuk është

të pranuar si provë. "Duke qenë se sportistja e ka të përsëritur pozitivitetin ndaj dopingut, do të dënohet me sanksionin maksimal që është 8 vjet dhe do të hiqen të gjitha rezultatet nga aktiviteti ku ka rezultuar pozitive dhe të gjitha rezultatet nga periudha e fillimit të kësaj çështjeje, që është fundi i vitit 2017", lexohet në vendimin e Federatës Botërore të Peshëngritjes. Romela Begaj ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv për të zhbërë këtë vendim të rëndë, por duket e vështirë që peshëngritësjatë të ndjekë këtë rrugë të gjatë dhe shumë të kushteshme ligjore. Një konfirmim për këtë vjen nga vetë Federata Shqiptare e Peshëngritjes. Të kontaktuar nga "News 24", drejtuesit e saj bëjnë të ditur se është e pamundur financiarisht të reklamojnë dënimin e Romela Begaj në KAS. Kjo do të thotë se me këtë vendim karriera e peshëngritjes ka ardhur në fund, për vetë faktin se ajo është 33 vjeç.

XHUDO

Kelmendi fenomenale, fiton medaljen e artë për 35 sekonda

Majlinda Kelmendi siguron një tjetër medalje të artë në palmaresin e saj, teksa në finalen e madhe të Grand Prix të Tel-Avivit, ka arritur të mposhtë izraeliten Gil Cohen, në një sfidë që ka zgjatur vetëm 35 sekonda. Xhudoka nga Peja fitoi pas një iponi të realizuar me sukses ndaj rivalëve, ndërsa kjo ishte fitorja e tretë radhazi në këtë Grand Prix me këtë lëvizje. 27-vjeçarja shfaqet kështu në një formë mjaft të mirë në botërorin e ardhshëm, ku do të shkojë për të synuar medaljen e artë.



ISH-SHOKËT

Lojtarët e Milanit tallen me Higuana: Te Çelsi s'ka masa XXL?


Janë vetëm çastet e para në Londër të Gonalzo Higuain me fanellën e Çelsit, me Pipitën që hedh në rrjetet sociale fotot e para të stërvitjes, por edhe shoqërinë e re. Por një nga këto foto ka sjellë dhe reagimin e ish-shokëve të tij të Milani, me të parin Hesuz Suso. Spanjollit, të cilit mesa duket ende nuk i ka kaluar inati i largimit të argentinasi nga Milani, vendos të tallt me të dhe i shkruan: "Ato pantallonat nuk mund t'i merrijnë një numër më të madh?". Hoze Mauri, i thirrur në debat nga vetë Suso, e ngre edhe më tej nivelin e shpirtit: "Më duket se atje nuk kanë masë më të madhe se sa XXL"... Eh fillimet e reja janë gjithnjë të vështira.




"AUSTRALIA OPEN"

Nadal është një "përbindësh" për grekun Cicipas

Shumë i fuqishëm, shumë i saktë, shumë i shpejtë. Ose me një fjalë, shumë i fortë për t'u mposhtur. Rafael Nadal ka fituar gjysmëfinalen e "Australia Open" përballë Stefanos Cicipas me rezultatit të pastër 3-0, duke dominuar tërësisht në të tria setet me rezultatet e thella 6-2, 6-4, 6-0. Endrra e bukur e tenistit grek në Melbourne merr fund kështu, ndonëse habiti që në fillim pasi eliminoi Roxher Federer, u pa si një kandidat potencial për fitoren finale. Por përpara numrit 2 të botës, këto gjëra nuk kishin aspak rëndësi. Spanjollit nuk vuri në diskutim asgjë në këtë sfidë dhe tashmë pret të mësojë rivalin e finales së madhe, rival që do të dalë nga gjysmëfinalja mes Novak Gjkoviçit dhe Lukas Pule.



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Riza aktor.
 - Një fjalë si hiç.
 - Një mund të jetë diplomatik.
 - Premtom të bëhet as.
 - Janë felinë... të zinj.
 - Ami i Maupassant.
 - Heroi i Emilio Salgarit.
 - Oe anarkist i famshëm rus
 - Një mungesë gjaku.
 - Susanna shkrimtare
 - Të parat në cilësi.
 - Mbyllin një shtëpi.
 - Mbeten në fund.
 - Qendër në kaos.
 - Ka bërë piktoreskë një i tillë
 - Inicialet e Camus.
 - Motra...e Kolë Idromenos
 - Një konfuzion total.
 - Rastet pa set.
 - Rastisin në krye.

- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (Indic).
- Triolet e Trëndafili me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez


- VERTIKAL**
- Fillojnë praktikën.
 - Britma e Arkimedit.
 - Ekstre në trap.
 - Në fund të fundit.
 - Janë fjetoret e ushtarëve
 - Parker regjisor.
 - Vivaldi kompozitor.
 - Një shkop për karambol.
 - Janë firmat rentiere.
 - Një i fundit mbi të gjithë
 - Kufizojnë tatimet
 - Janë nomadë.
 - Panik pa kufij.
 - Fryn detin
 - Sidney regjisor i Serpico.
 - Jep alamin.
 - Fillojnë nazet.
 - Janë illogari.
 - Alan regjisor.
 - Roman regjisor.
 - Eshhtë X ajo e sulmit.
 - Kapen të parat.
 - Një provë... inteligjence.
 - Një markë lap top.
 - Fillojnë matjet.
 - Ruga e Ferenc Molnar.
 - Qerre pa qe.
 - Fillojnë lirinë.
 - Fillojnë vallenë.
 - Në mes të dhomës.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
- Një doktor... i Fritz Lang
 - U paraprind hoteleve.
 - Kush nuk ka... nuk ha
 - Eshhtë djall
 - Një mund të ketë i rrallë.
 - Ishin perëndi të Samotrakias.
 - Institucione Botuese Autonome.
 - Eshhtë infeksion në bark
 - Fundi i një samurai.
 - Një markë kafeje.
 - Mbyllin një hark.
 - Mund të jetë emërore.
 - Ishite muzikanti që nuk përsërite.
 - Në krye të avokatëve.
 - Qerre pa qe.
 - Një pjesë e adoleshentëve.
 - Një banor imagjinar i planetit të kuq.
 - Nuk shuhej dot nga Tantali.

- Desnuda e Goya-s.
- Ruhet ajo sportive.
- Vetëvrasia e samurait.
- Drita pa kufizj.
- Eshhtë yll i skuadrës.
- I dashuri i Aidas.
- Eshhtë zhurmë
- Ishite lulja e harresës.


- VERTIKAL**
- James, armiku i Sherlock Holmes.
 - Eshhtë edhe ajo saudite.
 - Imami aktore
 - I kanë çift turket.
 - Inicialet e Seagal aktor.
 - Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
 - Në fund të lutjes.
 - Eshhtë sporti me stil të lirë.
 - Mbeten në fund.
 - Eshhtë rasti i veçantë, karakteristik.
 - Conan ai i Schwarzenegger.
 - Gjysmë ditari.
 - Mario, që qe qe bomber argjentinias.
 - Mund të prishej nga një... kleçkë.
 - Në hyrje të pistës.
 - Një numër... femrash.
 - Eshhtë qyteti i Besës
 - Qyteti që quhej edhe Sebaste.
 - Njëllotj për latinët.
 - Mund të bëjnë stil të lirë.
 - Damon aktor.
 - Eshhtë pije e jona.
 - Në krye të noterëve.
 - Film i Robert Altman.
 - Skuadra merengue.
 - Një pjesë e hasmërisë.
 - Rralle është përgjysmë.
 - Nisur pa kufij.
 - Fillojnë mobilizimin.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PËRGJIGJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

M	A	R	I	E	K	O	H	A	A	K	
F	I	L	L	I	D	O	M	A	T	E	R
R	A	F	T	M	I	M	R	A	T	I	S
A	A	P	E	R	I	P	A	T	I	M	
N	H	P	A	K	E	T	I	M	E	T	
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	S	T	
F	I	D	A	N	E	T	V	E	T	E	
S	E	N	A	T	I	I	B	E	R	I	K
S	E	N	E	K	A	L	L	A	P	A	T
T	R	E	L	S	A	T	T				
L	I	V	E	T	A	K	A	A	D		
N	A	A	R	N	T	E	A	P	E	L	
D	A	L	A	I	V	A	K	A	N	T	E
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	M	
R	R	E	M	I	R	E	T	T	R	I	O
T	E	S	T	R	T	A	T	E	O	L	
S	M	N	O	T	A	R	E	T	N	L	
K	A	A	M	E	R	I	K	A	N	E	
E	H	P	A	M	A	D	S	H			
K	O	L	O	N	A	O	T	E	C	E	
T	U	N	E	L	E	T	P	E	R	O	S
O	R	A	I	T	K	E	S	T	I	A	
K	A	N	S	A	R	A	H	E	P		
E	T	J	A	C	T	A	T	E	T	I	

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOKU

			6	7		3	5		
3						4	2		
	9				4	8		7	
	8		1	4		7			
9									
		3	5			9	1		
		8							
5	4				2				
6	3								

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

8	3	7	5	2	1	4	6	9	
2	9	1	6	3	4	5	7	8	
4	5	6	8	7	9	1	2	3	
9	4	2	1	5	6	3	8	7	
3	1	5	7	8	2	6	9	4	
6	7	8	9	4	3	2	1	5	
1	2	3	4	9	8	7	5	6	
5	8	4	2	6	7	9	3	1	
7	6	9	3	1	5	8	4	2	

Argëtim filozofik

- Dhuna është frut i dëshirës .
- Njëqind vite të jetës së një njeriu që nuk merr në konsideratë Ligjin Suprem, është e krahasueshëm vetëm me 1 ditë të jetës së atij që e respekton .
- Eshhtë e preferueshme të mos bëhet një vepër e bërë keq , sepse më pas do pendohemi . Atë që bëjmë , më mirë ta bëjmë të rregullt (mirë) , për të mos u penduar .
- Urrejti nuk ndalet nga urrëjtia , në asnjë kohë ; urrëjtja pushon nga dashuria : që është ligji i përjetshëm .

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2
	1	12	4	2	12	4	11		6	1	8	
4	11	2		5	10	3	1	15		12	2	
7	4	12		5	10	3	4	6	1	7	2	12
3			5	10	3	1	14	4	6	1		
4	12	2		5	1	7	2	12		11	4	3
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14
7	2	14	4	12		7	K	O	S	H	3	4
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12

I	R	S	E	R	B	B	I	D	E	T	
B	E	L	A	M	I	S	R	N	I		
I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
Z	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
A	R	I	T	I	U	I	T	A			
A	T	E	E	M	T	A	I	R	O		
K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
T	K	D	T	E	A	N	T	A			
U	N	I	O	N	M	R	T	K			
A	I	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
L	K	S	T	U	R	I	S	T	E	T	

Thënie të mençura

- Kujdesi shpie në përjetshmëri , moskujdesi në vdekje ; të kujdesshmit nuk vdesin
- kurrë , të pakujdesshmit janë si të vdekur .
- Nëse doni të arrini ndriçimin , nuk duhet të studioni mësimet e panumërta . Thellohuni vetëm të njëra . Cila ? Te dhembshuria e madhe .
- Më mirë të jesh endacak e të udhëtosh vetëm .
- sesa të mykesh në shoqërinë e budallenjve .
- Lëviz nëpër botë duke festuar , kërcyer , kënduar , si një bletë ; shko nga lulja në lule , vetëm duke provuar të gjitha eksperiencat , piqesh .

